



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM LËNDOR PËR ARSIMIN BAZË
NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE PËR TË MITUR**

Lënda: Gjuhë shqipe

Klasat: VI, VII, VIII, IX

Tiranë, 2018



	Emër Mbiemër	Pozicioni	Data	Nënshkrimi
Koordinoi:	E.Koleci	Specialist i Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Standardeve	___.11.2018	
Pranoi:	D.Rapti	Drejtori i Drejtorisë së Kurrikulës, Standardeve dhe Kualifikimit	___.11.2018	

Përmbajtja

I.	HYRJE.....	2
II.	KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE	3
III.	QËLLIMET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR	6
IV.	QËLLIMET E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE	6
V.	LIDHJA E KOMPETENCAVE KYÇ ME KOMPETENCAT E LËNDËS	7
VI.	LIDHJA E GJUHËS SHQIPE ME TEMAT NDËRKURRIKULARE	5
VII.	LIDHJA E LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE ME FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT.....	6
VIII.	PËRSHKRIMI I KOMPETENCAVE TË LËNDËS	9
IX.	NDARJA E KOHËS MËSIMORE PËR SECILËN KLASË	10
XI.	PËRMBAJTJA E SHKALLËS SË TRETË DHE E SHKALLËS SË KATËRT	12
	Tematikat.....	12
XII.	UDHËZIME METODOLOGJIKE	64
	Kriteret e procesit mësimor	66
	Puna me nxënësit me nevoja të veçanta, me nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe me nxënësit e talentuar.....	67
	Udhëzime për leximin e teksteve letrare dhe joletrare	68
XIII.	UDHËZIME PËR VLERËSIMIN	68
XIV.	MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE	70

I. HYRJE

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë synon zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që të përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të tregut të punës.

Mësimi i gjuhës shqipe zhvillon te nxënësit të menduarit kritik dhe i bën të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Nëpërmjet leximit të teksteve nga letërsia shqipe dhe ajo botërore, nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë dhe vlerësojnë gjuhën e kulturën kombëtare dhe ato botërore.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën dhe kuriozitetin e nxënësve për t’u bërë lexues aktivë e të pavarur dhe shkruar të saktë, origjinalë dhe krijues. Po kështu, ajo zhvillon te nxënësit njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e duhura që ata të flasin dhe të dëgjojnë në mënyrë korrekte në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë.

Arritjet gjuhësore të nxënësve janë përcaktuese jo vetëm për lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”, por dhe për çdo lëndë që zhvillohet në shkollë. Nëse nxënësit nuk janë të aftë të dëgjojnë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë mirë, ata nuk mund të jenë të suksesshëm në shkollë dhe në jetë. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë, janë një nga detyrat parësore të arsimit bazë.

Korniza kurrikulare përcakton si qëllim kryesor zotërimin e kompetencave kyç nga nxënësit. Ndërtimi dhe zhvillimi i këtyre kompetencave kyç janë të domosdoshëm për një individ, me qëllim që të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Çdo fushë të nxëni dhe lëndë synon që ta pajisë nxënësin me këto kompetenca. Këtë “mision”, lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj. Bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës së gjuhës shqipe, pesë kompetencat e saj janë:

- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.
- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar.
- Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare.
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.

- Përdorimi i drejtë i gjuhës.

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” përbëhet nga lëndët: **Gjuhë shqipe** dhe **Gjuhë e huaj e parë**. Njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësve në një gjuhë i ndihmojnë ata të mësojnë dhe të kuptojnë një gjuhë tjetër. P.sh., nxënësit zbatojnë dhe përdorin njohuritë gjuhësore të gjuhës amtare gjatë mësimin të një gjuhe të huaj. Mësimi i këtyre lëndëve përgjatë nëntë viteve të arsimit bazë është si më poshtë:

Gjuha shqipe mësohet në të gjitha shkallët e kurrikulës, nga klasa përgatitore deri në klasën e nëntë.

Gjuha e huaj e parë fillon në shkallën e dytë (klasa III) dhe mësohet deri në shkallën e katërt (klasa IX).

Të gjitha lëndët synojnë të pajisin nxënësit me kompetencat kyç dhe me kompetencat e lëndës.

II. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE

Hartimi i programit lëndor mbështetet në dokumentet kryesore kurrikulare: korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor. Përdoruesit e programit janë mësuesit, autorët e teksteve shkollore, prindërit dhe komuniteti, specialistët e arsimit dhe fakultetet e mësuesisë etj.

Mësuesit do ta përdorin programin e gjuhës shqipe për të krijuar një tablo të qartë rreth asaj se çfarë duhet të mësojnë nxënësit dhe se si duhet ta ndërtojnë mësimdhënien për të pajisur nxënësit me kompetencat kyç dhe të fushës, si dhe për të përmbushur kërkesat e programit.

Autorët e teksteve shkollore do ta përdorin programin e gjuhës shqipe për të hartuar tekste që janë në funksion të realizimit të programit mësimor përkatës. Leximi i kujdesshëm i programit për çdo shkallë dhe çdo klasë (nga klasa e parë deri në klasën e nëntë) do t'i ndihmojë për të siguruar koherencën dhe për të shmangur ngarkesën e panevojshme.

Prindërit dhe komuniteti mund të informohen nëpërmjet programit për kompetencat që duhet të zotërojnë fëmijët e tyre në lëndën e gjuhës shqipe.

Specialistët e arsimit mund ta përdorin programin e gjuhës shqipe për qëllime inspektimi, monitorimi, vlerësimi, studimi etj.


Fakultetet e mësuesisë duhet ta përdorin programin lëndor për të përshtatur kurrikulat e tyre, me qëllim përgatitjen efektive të mësuesve të ardhshëm, si dhe për praktikën profesionale të studentëve.

Programi i gjuhës shqipe ka në fokus realizimin e kompetencave kyç dhe të kompetencave të lëndës. Gjatë punës për përmbushjen e kompetencave kyç dhe të kompetencave të lëndës, nëpërmjet mësimit të gjuhës shqipe do të realizohen temat ndërkurrikulare që mundësojnë lidhjen e lëndës me jetën e përditshme, shoqërinë dhe tregun e punës.

Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e gjuhës shqipe me fushat e tjera, në mënyrë që formimi i nxënësit të mos jetë fragmentar, por i plotë dhe tërësor.

Në program janë përcaktuar njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë të fushës. *Njohuritë janë përcaktuar për çdo klasë, ndërsa aftësitë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet janë përcaktuar për shkallë.* Këto njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime janë klasifikuar sipas disa tematikave. Në program janë sugjeruar edhe orët mësimore për çdo kompetencë.

Diagrami i mëposhtëm paraqet organizimin e programit.



III. QËLLIMET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar, nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak e kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- përdorin teknologjitë e reja.

IV. QËLLIMET E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE

Qëllimet e programit të lëndës së gjuhës shqipe në arsimin bazë janë:

- Zhvillimi i aftësive për të folur, për të dëgjuar, për të lexuar dhe për të shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi i mendimit kritik e krijues nëpërmjet këtyre teksteve.
- Kërkimi, gjetja, gjykimi në mënyrë kritike dhe përdorimi i informacionit që merret nga mediat dhe interneti.
- Njohja dhe vlerësimi i letërsisë shqipe dhe i letërsisë botërore nëpërmjet studimit të krijimtarisë së shkrimtarëve përfaqësues të periudhave të ndryshme (tekste të përshtatshme për moshën e nxënësve).

- Krijimi i besimit se përmes letërsisë dhe teksteve joletrare zhvillohen mënyra e të menduarit, bota shpirtërore dhe personaliteti i njeriut.
- Zotërimi i njohurive, aftësive, shkathtësive dhe qëndrimeve të duhura rreth sistemit gjuhësor të shqipes.
- Vlerësimi i gjuhës shqipe si vlerë e kulturës sonë kombëtare dhe si mjet komunikimi.

V. LIDHJA E KOMPETENCAVE KYÇ ME KOMPETENCAT E LËNDËS

Realizimi i kompetencave kyç të Kornizës Kurrikulare gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyç me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për ta realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat, strategjitë dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënit. *Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për t'i trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.* Kur nxënësi përmbush kompetencat gjuhësore, ai është duke ndërtuar dhe duke zhvilluar njëkohësisht edhe kompetencat kyç. P.sh., gjatë prezantimeve të ndryshme në orët mësimore të kompetencës së të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar, nxënësi përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit dhe realizon kështu edhe kompetencën digjitale. Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës së gjuhës shqipe pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyç në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, në shoqëri dhe në punë.

Më konkretisht, për të realizuar lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës, mësuesi ndjek këta hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyç që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zberthen në rezultate të nxëni për kompetenca kyç për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënit për shkallë për kompetencat kyç;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizohen rezultatet e të nxënit;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave dhe projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për fushën “Gjuhët dhe komunikimi”.

Diagrami i mëposhtëm konkretizon lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës.




Tabela: Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe gjatë shkallës së tretë dhe shkallës së katërt

Në kurrikulën bërthamë janë përcaktuar rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë kyç. Këto rezultate realizohen nëpërmjet fushave të të nxënit. Natyrisht, secila fushë dhe lëndë mund të kontribuojë në disa rezultate të nxëni. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” ndihmon realizimin e të gjitha kompetencave, por, më së shumti, realizimin e kompetencës së komunikimit dhe të të shprehurit. Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e të nxënit të kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe gjatë shkallës së tretë dhe shkallës së katërt.

SHKALLA III	SHKALLA IV
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit	
<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit; dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime; lexon rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor, publicistik etj. dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim; shpjegon qartë dhe saktë, me gojë dhe me shkrim, kuptimin e fjalëve dhe të koncepteve të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm; 	<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> merr pjesë në bashkëbisedime me moshatarët dhe të rriturit për tema me interes mësimor dhe shoqëror duke bërë pyetje, duke dhënë përgjigje dhe duke veçuar informacionin kryesor; transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit; prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, duke gërshetuar format e komunikimit verbal dhe elektronik, si dhe veprimin praktik; përshkruan me gojë dhe me shkrim një ngjarje të lexuar ose të dëgjuar duke ruajtur rrjedhën logjike të saj;

<ol style="list-style-type: none"> 5. veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton atë dhe e shfrytëzon si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyre me shkrim; 6. shkruan një tekst deri në 500 fjalë (letër, udhëzim, kërkesë, ese etj.), duke respektuar rregullat gjuhësore; 7. shpreh drejt një mendim apo kërkesë, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare ose në gjuhë të huaj, për një situatë të caktuar (udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke bashkëvepruar në grup ose në klasë. 	<ol style="list-style-type: none"> 5. harton një tekst deri në 500 fjalë (bazuar në imagjinatën e vet), duke vazhduar një rrëfim gojor apo tekst të lexuar më parë; 6. analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun e përshtatshëm; 7. diskuton për një temë të caktuar në lëndë të ndryshme, duke respektuar rregullat e komunikimit; 8. identifikon burime të ndryshme informacioni për arsimim dhe orientim profesional, si dhe harton një plan individual për zhvillimin e karrierës së tij.
---	--

Kompetenca e të menduarit

<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. parashtron argumente <i>pro</i> ose <i>kundër</i> për një temë ose problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media; 2. shpreh mendimin e tij për një punim letrar apo artistik duke dalluar ndryshimet dhe analogjitë ndërmjet krijimeve të ngjashme; 3. harton planin e punës për realizimin e një krijimi ose detyre (letrare), duke përcaktuar hapat kryesorë të zbatimit; 4. zgjidh një problem (gjuhësor) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse; 5. përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një 	<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. paraqet argumente për të përforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara; 2. përzgjedh dhe klasifikon informacionin nga burime të ndryshme, në bazë të një kriteri të caktuar, për një temë konkrete dhe e përdor për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi ose detyre; 3. analizon një punim (artikull gazete, pikturë etj.) duke gjetur analogji dhe dallime me punime të ngjashme nga autorë të ndryshëm;
---	--

<p>problemi (gjuhësor) duke paraqitur rezultat të njëjtë;</p> <p>6. përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive ose krijimeve artistike.</p>	<p>4. përpunon idenë e vet në një projekt me shkrim për një çështje të caktuar duke propozuar qëllimin, aktivitetet kryesore, afatet, vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre dhe parashikon pengesat e mundshme gjatë realizimit;</p> <p>5. argumenton ndërmarrjen e hapave konkretë që çojnë në përfundimin e një detyre ose veprimtarie, zgjidhjen e një problemi, të ndonjë punimi në klasë, në shkollë ose jashtë saj;</p> <p>6. demonstroi zgjidhjen e një problemi, duke u bazuar në të dhënat tekstuale, numerike, eksperimentale të detyrës, e cila realizohet në klasë, në shkollë ose jashtë saj;</p> <p>7. interpreton, me shkrim dhe me gojë, një rregull, një koncept apo një proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.</p>
---	---

Kompetenca e të nxënit

<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës ose detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën; 2. zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, 	<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. regjistron në formë të shkruar, grafike etj., informacionin/faktet për një temë; veçon me anë të teknikave të ndryshme pjesët sipas rëndësisë dhe nevojës për temën/detyrën e dhënë; 2. shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë e informacionit apo burime të tjera për zhvillimin e një ideje /projekti në bazë klase/shkolle ose jashtë saj;
--	--

<p>veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;</p> <ol style="list-style-type: none"> 3. shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe të mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe të përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar; 4. lidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike; 5. përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme të dijes; 6. parashtron pyetje (<i>Pse? Çfarë? Si? Kur?</i>) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën ose problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur; 7. menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre ose veprimtarie (në klasë, në shkollë apo diku tjetër). 	<ol style="list-style-type: none"> 3. regjistron, skedon dhe përdor teknika të tjera për të menaxhuar informacionin/ faktet ose formulat për një temë duke i radhitur ato sipas llojit, burimit dhe rëndësisë; 4. parashtron pyetje për çështje të ndryshme dhe organizon mendimet për të gjetur përgjigje për temën apo problemin e caktuar duke evidentuar përparimin/vështirësitë deri në zgjidhjen përfundimtare; 5. paraqet ose skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një veprimtarie duke e argumentuar para të tjerëve; 6. prezanton në mënyrë të pavarur udhëzimet/simbolet e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., për të përmbushur një veprim, veprimtari ose detyrë që kërkohet prej tij; 7. shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke klasifikuar informacionin e njohur nga ai i panjohur, si dhe atë që është i paqartë; 8. përdor elementet e portofolit personal për vetëvlerësimin dhe identifikimin e anëve të forta, i shfrytëzon ato për përparimin në mësim dhe për orientimin për karrierë.
<p>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. përgatit planin e punës për organizimin e një veprimtarie të 	<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin

<p>caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses;</p> <p>2. përdor programet kompjuterike për përgatitjen dhe ilustrimin e materialeve të nevojshme grafike (ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve);</p> <p>3. bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një veprimtarie të përbashkët (në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).</p>	<p>e komunitetit nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta e përditshme;</p> <p>2. përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparimin në mësim dhe për orientimin për karrierë.</p>
Kompetenca personale	
<p>Nxënësi:</p> <p>1. merr pjesë ose drejton punën në grup, bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike, etj., dhe raporton (me gojë dhe me shkrim) për përvojat personale të fituara.</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>1. analizon shkaqet e një reagimi konfliktual apo emocional dhe propozon alternativa për zgjidhje të drejtë e pa pasoja duke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit.</p>
Kompetenca qytetare	
<p>Nxënësi:</p> <p>1. zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj. dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë;</p> <p>2. merr pjesë në veprimtaritë që promovojnë tolerancë dhe</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>1. praktikon të drejtat dhe detyrimet si qytetar në situata konkrete të jetës së përditshme, në klasë, në shkollë, në komunitet, ose gjatë diskutimit dhe respektimit të mendimit të tjetrit;</p> <p>2. përgatit në grup një veprimtari, duke përdor tolerancën si mjet për</p>

shumëllojshmëri kulturore, etnike, fetare, gjinore etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në bashkësinë e gjerë.	promovimin e shumëllojshmërisë kulturore, etnike, fetare, gjinore, sociale etj., në shkollë apo në komunitet.
Kompetenca digjitale	
<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive; 2. analizon, vlerëson dhe menaxhon informacionin e marrë në formë elektronike (p.sh., hedh disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik). 	<p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. përdor TIK-un për të lehtësuar procesin e të nxënës dhe për të rritur efektivitetin në të nxënë; 2. përdor mjetet multimediale për të bashkëpunuar me persona të tjerë dhe për të rritur produktivitetin e tij dhe të nxënës efektiv.

VI. LIDHJA E GJUHËS SHQIPE ME TEMAT NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Ato integrojnë fushat e të nxënës që ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të lidhin dijet e marra në shkollë me jetën dhe me interesat e tyre. Në Kornizën Kurrikulare dhe në kurrikulat bërthamë janë përcaktuar temat ndërkurrikulare, të cilat janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Të drejtat e njeriut.
- Vendimmarrja morale.
- Mjedisi.

- Bashkëjetesa paqësore.

Lënda e gjuhës shqipe, për specifikat dhe hapësirat që ka (sasia e orëve mësimore), lejon krijimin e situatave mësimore të cilat mundësojnë trajtimin e këtyre temave. Kështu p.sh., leximi dhe studimi i teksteve të ndryshme letrare nga letërsia shqipe dhe ajo botërore zhvillojnë te nxënësit identitetin dhe krenarinë kombëtare dhe njohjen e vlerësimit të kulturës botërore. Tema, si: të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm etj., mund të realizohen gjatë diskutimeve dhe bashkëbisedimeve në grup që mund të zhvillohen gjatë orëve mësimore të kompetencës së të folurit. Mësuesi mund të krijojë edhe situata mësimore, gjatë të cilave nxënësit shprehën në forma të ndryshme: ese, poezi, tregime dhe krijime të tjera me tematikë rreth çështjeve të mësipërme. Punët në grupe që zhvillohen në lëndën e gjuhës shqipe ndihmojnë në krijimin e aftësive të nxënësve për të jetuar në mënyrë paqësore me të tjerët.

VII. LIDHJA E LËNDËS SË GJUHËS SHQIPE ME FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT

Mësimi i gjuhës shqipe në shkollë mbështet edhe ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të fushave të tjera të kurrikulës. Në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit fitojnë njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar me gojë dhe me shkrim; lexojnë dhe kuptojnë tekste të llojeve të ndryshme; pasurojnë fjalorin dhe botëkuptimin e tyre duke lexuar tekste letrare dhe joletrare; mësojnë të shkruajnë tekste të ndryshme (opinione, raporte, udhëzime etj.); mësojnë ta përdorin drejt nga ana gramatikore dhe drejtshkrimore gjuhën etj. Të gjitha këto njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime sigurojnë suksesin e nxënësve edhe në fushat dhe lëndët e tjera. Natyrisht, në këtë lidhje ka marrje dhe dhënie. P.sh., aftësitë e të lexuarit mbështesin kuptimin e ushtrimeve dhe të teksteve matematikore. Nga ana tjetër, aftësitë për të zgjidhur probleme në matematikë ndikojnë në gjykimin dhe mendimin kritik të nxënësve rreth teksteve të ndryshme.


Kuptimi ose analiza e teksteve të shkencave të natyrës kërkon aftësi të mira leximi. Leximi i një proze, p.sh., i ndihmon nxënësit të marrin njohuri rreth natyrës, siç njohuritë e marra në shkencat e natyrës nxitin imagjinatën për të realizuar me shkrim një përshkrim të natyrës.

Lënda e gjuhës shqipe mbështet nxënësit në mësimin e shkencave shoqërore. Leximi dhe analiza e teksteve letrare ndikon që të kuptohen më mirë ngjarjet e figurat historike, marrëdhëniet mes njerëzve dhe vlerat shoqërore.

Mësimi i arteve të ndryshme mbështetet nga gjuha shqipe (tekstet letrare që studiohen nga nxënësit). Kështu, analiza e teksteve letrare i ndihmon nxënësit të kuptojnë mjetet e shprehjes artistike; studimi dhe krijimi i teksteve të ndryshme si, p.sh., i reklamave, kërkojnë integrim me artet për elementet pamore të reklamave; ilustrimi i një analize të një teksti letrar me muzikën e një periudhe të caktuar i ndihmon nxënësit të kuptojnë efektin emocional të muzikës dhe mjetet e shprehjes artistike të saj. Element i përbashkët mes muzikës dhe gjuhës shqipe janë edhe këngët popullore dhe krijimet e tjera folklorike, studimi i të cilave integron gjuhën dhe artet.

Shembujt e mësipërm janë vetëm një nxitje për të kuptuar se në procesin mësimor krijohen mundësi për integrim mes fushave të të nxënit. Mësuesit, me pasionin dhe përkushtimin që i karakterizon, mund të realizojnë pafund integrame mes fushave dhe lëndëve në situata të ndryshme të nxëni. Ky integrim shmang marrjen e njohurive të fragmentuara dhe të shkëputura nga jeta.

Në diagramin e mëposhtëm janë dhënë aftësitë që lënda e gjuhës shqipe u siguron fushave të tjera të të nxënit.



VIII. PËRSHKRIMI I KOMPETENCAVE TË LËNDËS

a) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësit marrin njohuri, zhvillojnë qëndrime dhe vlera, si dhe zbatojnë aftësi dhe shkathtësi duke dëgjuar tekste të ndryshme. Më konkretisht, nxënësit kuptojnë se sjellja dhe qëndrimet e duhura gjatë të dëgjuarit ndikojnë pozitivisht tek të tjerët. Ata dallojnë disa cilësi të zërit të folësit, si: intonacioni, ritmi, theksi, lartësia e zërit. Gjithashtu, nxënësit tregojnë brendinë, veçojnë idenë kryesore, dallojnë fjalët ose frazat kyç, nxjerrin përfundime, krahasojnë ose klasifikojnë, si dhe bëjnë vlerësime të thjeshta për tekstet që dëgjojnë.

b) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Nxënësit përdorin drejt gjuhën standarde gjatë folurit; kuptojnë dhe zbatojnë në komunikim karakteristikat e gjuhës së folur; shqiptojnë saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jenë të kuptueshëm dhe interesantë për të tjerët; shoqërojnë të folurin edhe me elemente të komunikimit joverbal; diskutojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët gjatë punës në grup.

c) Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Nxënësit lexojnë tekste letrare dhe joletrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, shqipe dhe botërore, dhe demonstrojnë kuptimin, interpretimin, analizën, vlerësimin dhe gjykimin e këtyre teksteve (të përshtatshme për zhvillimin moshor të nxënësve).

ç) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësit shkruajnë për qëllime personale dhe për lexues të ndryshëm. Ata ndjekin gjatë të shkruarit hapa, si: planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi. Nxënësit, gjithashtu, respektojnë strukturën, tiparet e tekstit, si dhe zbatojnë rregullat gjuhësore.

d) Përdorimi i drejtë i gjuhës

Që nxënësit të flasin dhe të shkruajnë në mënyrën e duhur, ata duhet të zotërojnë njohuri e të demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të huaja. Kështu, nxënësit dallojnë pjesët e ndryshme të ligjëratës e kategoritë gramatikore të tyre dhe i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit; dallojnë llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbatojnë këto njohuri në komunikimin e përditshëm; përdorin gjuhën standarde, njohin dialektet e pjesë të tjera të leksikut dhe respektojnë diversitetin gjuhësor; kanë njohuri për mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe; dallojnë kuptimet e fjalëve dhe i përdorin për të pasuruar fjalorin e tyre.

IX. NDARJA E KOHËS MËSIMORE PËR SECILËN KLASË

Lënda “Gjuhë shqipe” është e detyrueshme në arsimin bazë. Ajo zhvillohet përgjatë nëntë viteve të këtij arsimi dhe zë afërsisht 1/4 e kurrikulës. Në tabelën e mëposhtme është dhënë koha mësimore sipas kompetencave, gjatë shkallës së tretë dhe shkallës së katërt (klasat VI-IX). Këto kompetenca zhvillohen dhe përfitohen në proces, gjë që kupton zhvillimin e tyre ditë pas dite. Ato janë aq të lidhura dhe të ndërvarura mes tyre, sa që nuk ka kufi të prerë, ndaj shpërndarja e orëve është sugjeruese. Shuma e tyre është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit bazë.

Koha mësimore për çdo kompetencë përdoret për njohuri të reja, për përsëritje, për projekte, për vlerësime etj. Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10 për qind të orëve të një kompetence.

Nxënësit, në lëndën e gjuhës shqipe, pothuajse çdo orë flasin, dëgjojnë, lexojnë, shkruajnë dhe fitojnë njohuri dhe shkathtësi rreth sistemit gjuhësor. Megjithatë, theksi vihet në njërin nga këto kompetenca. Ky fakt përcakton edhe orët për këtë kompetencë. P.sh., në klasën e gjashtë janë përcaktuar rreth 15 orë për kompetencën “Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale”. Kjo do të thotë që nxënësit do të shkruajnë, pothuajse në çdo orë mësimi, por theksi në këto 15 orë do të vihet më shumë te kjo kompetencë.

Kompetencat/ klasat	Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare	Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	Përdorimi i drejtë i gjuhës	Totali
Klasa e gjashtë	5	5	35	15	30	90 orë
Klasa e shtatë	5	5	35	15	30	90 orë
SHKALLA E TRETË	10	10	70	30	60	180 orë
Klasa e tetë	5	5	35	15	30	90 orë
Klasa e nëntë	5	5	35	15	30	90 orë
SHKALLA E KATËRT	10	10	70	30	60	180 orë

X. QËLLIMET E SHKALLËS SË TRETË DHE TË SHKALLËS SË KATËRT

Gjatë shkallës së tretë dhe shkallës së katërt, nxënësit:

- komunikojnë qartë dhe saktë (me gojë dhe me shkrim) në varësi edhe të qëllimit dhe të situatës;
- shprehin opinionet e tyre, në mënyrë korrekte nga ana gjuhësore, gjatë diskutimeve dhe punëve në grup;
- dëgjojnë, lexojnë dhe kuptojnë lloje të ndryshme tekstesh, nxjerrin përfundime dhe i vlerësojnë këto tekste (me gojë ose me shkrim);

- gjejnë informacion në media dhe internet, e gjykojnë në mënyrë kritike këtë informacion dhe e përdorin atë në mënyrën e duhur;
- njohin llojet e ndryshme të teksteve dhe përdorimet e tyre, si dhe hartojnë e prezantojnë tekste të ndryshme;
- lexojnë tekste letrare të gjinive të ndryshme dhe zhvillojnë botën emocionale përmes tyre;
- vlerësojnë letërsinë si pjesë e rëndësishme e kulturës kombëtare dhe botërore;
- kuptojnë, interpretojnë dhe analizojnë tekste letrare si një burim për të njohur histori të ndryshme, marrëdhëniet njerëzore, ndjenjat, vlerat etj.;
- përdorin gjuhën standarde në shkollë dhe jashtë saj, si dhe zbatojnë rregullat gramatikore themelore;
- kuptojnë rëndësinë e gjuhës shqipe si vlerë e kulturës kombëtare.

XI. PËRMBAJTJA E SHKALLËS SË TRETË DHE E SHKALLËS SË KATËRT

Në programin e gjuhës shqipe për shkallën e tretë dhe shkallën e katërt janë paraqitur rezultatet e të nxënit për çdo kompetencë. Kompetencat zhvillohen përmes disa *tematikave*. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që realizimi i tyre përgjatë vitit shkollor ose shkallës të zhvillohet e ndarë në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në orë mësimi, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve). Më poshtë janë dhënë tematikat për çdo kompetencë.

Tematikat

a) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

- Rregullat e të dëgjuarit.
- Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të vlerësuar tekstin.

b) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

- Rregullat dhe organizimi i të folurit.
- Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup.

c) Të lexuarit e teksteve të ndryshme

- Të lexuarit për të kuptuar.
- Të lexuarit e teksteve letrare.
- Të lexuarit e teksteve joletrare.

ç) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

- Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit.
- Të shkruarit për qëllime personale.
- Të shkruarit për qëllime funksionale.

d) Përdorimi i drejtë i gjuhës

- Sintaksë.
- Morfologji.
- Leksikologji dhe semantikë.
- Drejtshkrim.
- Fonetikë dhe fonologji.



SHKALLA III
KLASAT VI - VII

KOMPETENCA: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Nxënësi demonstroi vëmendje, interes, respekt dhe empati (ndjeshmëri) për folësin. Ai kupton tekstet që dëgjon, lidh informacionin ose përmbajtjen e tekstit me jetën dhe njohuritë e tij. Nxënësi jep gjykimet e tij rreth tekstit që dëgjon, si dhe dallon qëllimin dhe ndjenjat e folësit. Ai, gjithashtu, zhvillon aftësitë për të krahasuar dhe për të vlerësuar tekste të ndryshme (të shkruara, të prezantuara dhe mediatike).

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- kupton, krahason dhe përmbledh mendimet e të tjerëve nga materialet e dëgjuara, të shikuara ose të prezantuara, si dhe reflekton për to;
- jep mendimet dhe gjykimet e tij rreth teksteve që dëgjon.

Njohuritë	Shkathtësitë
<p>Njohuritë për klasën e gjashtë</p> <p>Gjatë orëve mësimore të përcaktuara në program, nxënësi dëgjon dhe punon (tregon përmbajtjen ose brendinë, analizon, jep gjykime të thjeshta etj.) me tekste të cilat janë të përshtatshme për moshën e tij, si p.sh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lloje të ndryshme poezish; - rrëfime personale (anekdota gojore, ngjarje të jetuara); - tregime të shkurtra. - udhëzime të shkurtra. <p>Nxënësi, gjithashtu, merr njohuri, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Renditja e ngjarjeve në një tekst. - Identifikimi i shkakut dhe i pasojës në një tekst. - Identifikimi i problemit dhe i zgjidhjes në një tekst. 	<p>Rregullat e të dëgjuarit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dëgjon me vëmendje dhe përqendrim, duke parë në sy personin që flet, si dhe duke mbajtur trupin në një pozicion korrekt; - shfaq interes, respekt dhe empati (ndjeshmëri) ndaj folësit me shprehje, të tilla si: <i>Pas një përvoje të tillë, e imagjinoj si jeni ndier etj.</i>; - nxit dhe inkurajon folësin me shprehje, të tilla si: <i>Kjo që po rrëfeni, është shumë interesante etj.</i> <p>Të dëgjuarit për të kuptuar dhe vlerësuar tekstin</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton qëllimin e të dëgjuarit (për kënaqësi, për informacion, për kuriozitet etj.); - kujton njohuritë paraprake që ka rreth temës ose rreth përmbajtjes së tekstit; - bën parashikime rreth tekstit që do të dëgjojë; - mban shënime gjatë të dëgjuarit; - pyet ose kërkon sqarime për idetë, konceptet ose fjalët që nuk i
<p>Njohuritë për klasën e shtatë</p> <p>Gjatë orëve mësimore të sugjeruara në program, nxënësi dëgjon dhe punon (tregon përmbajtjen ose brendinë, analizon, gjykon) me tekste të cilat janë të përshtatshme për moshën e tij, si p.sh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kërkesa, shpjegime; - udhëzime; - rrëfime personale (anekdota gojore, ngjarje të jetuara); 	

<ul style="list-style-type: none"> - reklama etj. <p>Nxënësi, gjithashtu, merr njohuri, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi i ndjenjave të folësit. - Përcaktimi i qëllimit të folësit. 	<p>kupton mirë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - kërkon informacion shtesë; - tregon me detaje dhe ilustrime përmbajtjen ose brendinë e tekstit; - interpreton tekstin duke dhënë gjykimet e tij; - identifikon ngjashmëri dhe dallime mes informacioneve që dëgjon nga burime të ndryshme (në biseda, në televizion ose në ndonjë media tjetër); - dallon rendin e ngjarjeve dhe të ideve; - klasifikon detajet në një tekst; - dallon shkakun dhe pasojën në një tekst; - dallon problemin dhe zgjidhjen në një tekst; - përcakton (me ndihmën e mësuesit) qëllimin ose synimin e folësit (këshillon, bind, sqaron etj.); - dallon ndjenjat e folësit.
<p>Vlerat dhe qëndrimet</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi vullnet dhe besim gjatë kryerjes së detyrave; - punon dhe diskuton me të tjerët gjatë punëve në grupe; - shfaq tolerancë dhe respekt për gjuhën dhe kulturën e tjetrit. 	

KOMPETENCA: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Përshkrimi i tematikave të kompetencës Nxënësi kupton dhe merr pjesë në biseda, diskutime dhe debate, si dhe vazhdon të zhvillojë aftësitë dhe shkathtësitë e tij për të bashkëpunuar me të tjerët në prezantime detyrash, projektesh e krijimesh të ndryshme. Ai përshtat të folurin me qëllimin, situatën dhe dëgjuesin.	
Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- zgjedh formën e përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, ndjenjat dhe pikëpamjet e tij;- merr pjesë në biseda shoqërore dhe diskutime me moshatarët dhe të rriturit mbi tema të njohura duke pyetur dhe duke dhënë përgjigje për pyetjet që i bëhen;- identifikon materiale të ndryshme dhe i përdor ato për të dhënë mesazhe ose porosi nëpërmjet reklamave e lajmërimeve, si dhe bën prezantimin e tyre në media.	
Njohuritë	Shkathtësitë
Njohuritë për klasën e gjashtë Gjatë bisedave dhe diskutimeve në klasë rreth temave, ¹ si: <i>mbresa udhëtimesh brenda dhe jashtë vendit, përshtatja në një mjedis të ri, leximet, pasionet dhe aktiviteti fizik, festat dhe rëndësia e tyre etj.</i> , nxënësi merr edhe njohuritë e mëposhtme:	Rregullat dhe organizimi i të folurit Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">- flet duke përdorur intonacionin e duhur, theksin e saktë (të fjalëve dhe të fjalive), vëllimin e përshtatshëm të zërit, si dhe pauzat (pushimet) për të bërë përshtypje tek të tjerët;

¹ Tematikat e dhëna në këtë kompetencë janë sugjeruese. Autorët e teksteve dhe mësuesit janë të lirë të zgjedhin edhe tema të tjera, në varësi të dëshirave dhe interesave të nxënësve.

<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi me të rriturit dhe bashkëmoshatarët (ndryshimet në komunikim). - Diskutimi rreth një teme të dhënë dhe reagimi ndaj vërejtjeve të të tjerëve. - Vlerësimi i ideve dhe i opinioneve të të tjerëve gjatë një diskutimi. 	<ul style="list-style-type: none"> - jep informacione, ide, ndjesi, emocione duke përdorur fjalorin e duhur; - përshtat të folurin në varësi të tematikës, dëgjuesit, qëllimit dhe situatës; - përdor gjuhën standarde në situata formale dhe joformale, duke përfshirë edhe diskutimet në klasë;
<p>Njohuritë për klasën e shtatë</p> <p>Gjatë këtyre orëve zhvillohen biseda dhe diskutime në klasë rreth temave, si: <i>angazhimi në komunitet, përgjegjësitë dhe të drejtat e nxënësve në shkollë, komunikimi në një mjedis virtual, çfarë u pëlqen nxënësve të lexojnë, veprimtaritë shkollore, rëndësia e përdorimit të gjuhës standarde në komunikim etj.,</i></p> <p>Nxënësi, gjithashtu, fiton edhe njohuri, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i gjuhës në mjedise të ndryshme komunikimi (në shkollë dhe në publik). - Ndryshimet mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar (njohuri të përgjithshme). - Elementet e komunikimit (skema e komunikimit). 	<ul style="list-style-type: none"> - gjedh fjalët dhe frazat e duhura për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit; - përgatit prezantime duke përdorur edhe teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit; - veçon disa ndryshime mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar; - dallon elementet e komunikimit në një situatë të dhënë. <p>Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - bën pyetje për t'u sqaruar dhe për të marrë më shumë informacion gjatë diskutimeve në grup; - ofron të dhëna ose informacion, si dhe shpreh mendimin ose këndvështrimin e tij personal; - jep mendimet dhe argumentet e tij gjatë diskutimeve në grup, si dhe pranon mendimet dhe idetë e të tjerëve; - reciton me ndjenjë pjesë të ndryshme para bashkëmoshatarëve dhe

	<p>mësuesve në veprimtari të ndryshme në shkollë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - planifikon dhe organizon lojëra me role me shokët dhe shoqet e klasës.
Vlerat dhe qëndrimet	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - flet në përputhje me normat e vlerat shoqërore, në situata të ndryshme komunikimi në klasë; - përdor në mënyrë korrekte gjatë të folurit elementet joverbale, si: gjestet, mimika, kontakti me sy; - shfaq me siguri e besim në vetvete mendimet, përvojat dhe argumentet e tij; - nxit diskutimet në grup duke ofruar kontributin e tij; - diskuton bashkërisht në grup për të arritur objektivin e një detyre duke ofruar idetë, zgjidhjet dhe këndvështrimet e tij. 	

KOMPETENCA: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Nxënësit përzgjedh tekstin që lexon në varësi të qëllimit që ka. Ai përdor disa strategji (para, gjatë dhe pas leximit) për të kuptuar tekstin. Nxënësi demonstroi të kuptuarit e tekstit duke treguar brendinë dhe duke e ilustruar atë me shembuj dhe detaje nga teksti. Ai gjykon me argumente idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar, dallon elemente të formës dhe të përmbajtjes së teksteve, krahason personazhe, ide, informacione etj. Nxënësi zbulon ngjashmëritë dhe ndryshimet mes teksteve. Ai lexon, kupton, interpreton, vlerëson dhe gjykon një shumëllojshmëri tekstesh letrare dhe joletrare.

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - interpreton tekstet duke përdorur idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst dhe idetë e nënkuptuara; - dallon informacionin e rëndësishëm në tekst; - lidh pjesët e ndryshme të një teksti dhe i analizon ato. <p>a) Tekste letrare</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon gjuhën e figurshme në tekste të ndryshme poetike, tregimtare dhe dramatike; - dallon temën dhe analizon personazhet, mjedisin, kohën dhe subjektin në një tekst tregimtar dhe dramatik; - dallon mjetet shprehëse në një tekst poetik dhe tregon funksionin e tyre; - shpreh pëlqimet dhe mbron interpretimet e tij duke i ilustruar me detaje dhe me pjesë nga teksti. <p>b) Tekste joletrare</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon përdorimin e gjuhës dhe terminologjisë së fushës në tekste të ndryshme; - kupton tiparet e strukturës dhe të organizimit në tekste të ndryshme (paragrafë, tituj, nëntituj etj.). 	
Njohuritë	Shkathhtësitë
<p>Njohuritë për klasën e gjashtë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Strategjitë e të lexuarit. - Teknikat e recitimit. <p>Studim tekstesh letrare: Gjatë studimit të këtyre teksteve, nxënësit kuptojnë, interpretojnë, analizojnë dhe gjykojnë, si</p>	<p>Të lexuarit për të kuptuar tekstin²</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh tekstin që lexon në varësi të qëllimit që ka, si p.sh.: një fjalor për të sqaruar e për të gjetur kuptimin e një fjale; një enciklopedi për fëmijë që të marrë informacion; një biografi për t'u

² Këto aftësi dhe shkathhtësi janë të përbashkëta për tekstet letrare dhe ato joletrare.

<p>dhe marrin njohuri, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Renditja e ngjarjeve në një tekst (rrëfyes ose dramatik). - Analiza e personazheve. - Dallimi mes teksteve letrare dhe teksteve joletrare (shkurtimisht). - Metafora, personifikimi, hiperbola, aliteracioni. <p>Studim tekstesh joletrare:</p> <p>Gjatë këtyre orëve mësimore, nxënësit punojnë (kuptojnë, interpretojnë, analizojnë, krahasojnë, gjykojnë, vlerësojnë) me tekste nga kultura dhe periudha të ndryshme, elektronike dhe të shtypura, si: intervista, enciklopedi të shtypura dhe elektronike, udhëzime, artikuj gazetash dhe revistash, njoftime, shpjegime.</p> <p>Gjatë studimit të këtyre teksteve, nxënësit marrin edhe njohuri, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tiparet e përgjithshme të një interviste, enciklopedie, udhëzimi, njoftimi ose shpjegimi. - Tiparet e gjuhës në një tekst joletrar (shkurtimisht). - Funkzioni i <i>grafikëve, tabelave, pikturave, ilustrimeve</i> etj. që shoqërojnë tekstet. 	<p>njohur me jetën dhe veprën e një autori; një përmbledhje me tregime, një vëllim me poezi ose një roman për fëmijë për kënaqësi etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor disa strategji (para, gjatë dhe pas leximit) për të kuptuar tekstin, si p.sh.: <i>aktivizon njohuritë e mëparshme nëpërmjet një diskutimi në grup; lexon pjesë-pjesë tekstin dhe parashikon se çfarë do të ndodhë më pas duke dhënë arsyetime dhe argumente për parashikimin e tij; analizon elementet që shoqërojnë tekstet (piktura, ilustrime, lista, tabela, harta etj.) për të kuptuar më mirë tekstin; i rikthehet leximit të tekstit derisa ta kuptojë atë;</i> - përmbledh idetë kryesore duke i ilustruar me shembuj dhe detaje nga teksti; - u përgjigjet pyetjeve të mësuesit rreth brendisë së tekstit; - lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën ose leximet e mëparshme; - krahason në një tekst dy ose më shumë ide, koncepte, detaje, personazhe etj.; - gjykon me argumente idetë dhe informacionin e tekstit (<i>A mendoni se ky veprim zbulon diçka nga karakteri i personazhit? Ku e mbështetni mendimin tuaj?</i>); - interpreton idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar në tekst (<i>Pse autori nuk e jep në mënyrë të drejtpërdrejtë</i>
<p>Njohuritë për klasën e shtatë</p> <p>Studim tekstesh letrare: poezi, këngë popullore, poema,</p>	

<p>fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, mite, romane për fëmijë, tekste të thjeshta dramatike.</p> <p>Gjatë studimit të këtyre teksteve, nxënësit marrin edhe njohuri, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Jeta dhe vepra e autorit të tekstit (shkurtimisht). - Tema, ideja kryesore, subjekti. - Tiparet kryesore të një teksti poetik, teksti në prozë dhe teksti dramatik (p.sh., tiparet e përrallave, fabulave, legjendave apo tregimeve). - Llojet kryesore të strofave dhe rimave. - Mjedisi dhe koha në një tekst letrar. - Përdorimi i epitetit, metaforës, krahasimit, hiperbolës, aliteracionit, metaforës, personifikimit dhe efekti që krijojnë. - Personazhet kryesore dhe personazhet dytësore. <p>Studim tekstesh joletrare: Nxënësit punojnë (kuptojnë, interpretojnë, analizojnë, krahasojnë, sintetizojnë, vlerësojnë) me tekste nga kultura dhe periudha të ndryshme, elektronike dhe të shtypura, si: autobiografi, biografi (të një shkrimtari, sportisti, shkencëtari etj.), intervista, enciklopedi të shtypura dhe elektronike, udhëzime, rregullore, kronika, ese, njoftime</p>	<p><i>këtë ide? Si e kuptoni ju?);</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon tekstet letrare dhe ato joletrare; - dallon elemente të formës dhe të përmbajtjes së teksteve dhe sqaron funksionin e tyre. <p>Të lexuarit e teksteve letrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon tekste të ndryshme letrare poetike, në prozë dhe dramatike (<i>të përshtatshme për moshën e tij</i>); - flet shkurt (<i>3-4 fjali</i>) për autorin e tekstit letrar (<i>momentet kryesore të jetës dhe të veprës</i>); - diskuton rreth përmbajtjes, personazheve, përshtypjeve dhe ndjesive për tekstet që lexon; - tregon brendinë ose përmbajtjen duke u bazuar në fjalët kyç, skicat ose fotografitë e figurat; - bën pyetje të ndryshme rreth tekstit; - u përgjigjet pyetjeve rreth tekstit me fjalët e tij ose me shembuj nga teksti; - rendit ngjarjet e një teksti; - përshkruan kohën dhe mjedisin ku ndodhin ngjarjet; - përshkruan pamjen e jashtme, tiparet dhe sjelljen e personazheve (<i>duke u bazuar në tekst</i>);
---	---

<p>etj.</p> <p>Gjatë studimit të këtyre teksteve, nxënësit marrin edhe njohuri, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tiparet e përgjithshme të një autobiografie, biografie, rregulloreje, eseje. - Organizimi i tekstit (<i>rend kronologjik, shkak dhe pasojë etj.</i>). - Fakti dhe opinioni në një tekst. 	<ul style="list-style-type: none"> - analizon marrëdhëniet mes personazheve, vlerëson sjelljet e tyre, si dhe i krahason me veten ose me njerëzit që njeh; - gjen idetë kryesore në një tekst dhe formulon temën dhe idenë kryesore; - jep dhe argumenton këndvështrimet e tij rreth temës, ideve, personazheve etj.; - kërkon informacion për fjalët e panjohura dhe mëson t'i përdorë ato; - dallon epitetin, krahasimin, metaforën, hiperbolën, aliteracionin, personifikimin dhe tregon efektin që krijojnë; - shpjegon kuptimin e një teksti poetik, duke u bazuar në ndjenjat dhe në përvojën e tij; - dallon rimën dhe strofën (llojet kryesore) në një tekst poetik; - dallon disa karakteristika të disa teksteve në prozë, si: <i>fabulat</i> (personazhet, personifikimi, alegoria, morali i fabulës); <i>përrallat</i> (elementet fantastike, formulat e hyrjes dhe të mbylljes, personazhet joreale, formulat e magjisë, fundi i lumtur, hiperbolat etj.); <i>anekdotat</i> (karakteri i personazheve, ironia, krahasimi etj.); - dallon dhe analizon disa elemente të strukturës së një teksti dramatik, si: skena, aktet, personazhet, fjalët e personazheve, didaskalitë; - përdor bibliotekën dhe internetin për të lexuar tekste të ndryshme; - reciton me ndjenjë poezi dhe copëza proze;
--	---

- luan një rol nga një tekst dramatik.

Të lexuarit e teksteve joletrare

Nxënësi:

- lexon tekste nga kultura dhe periudha të ndryshme, elektronike dhe të shtypura, si: autobiografi, biografi (*të një shkrimtari, sportisti, shkencëtari*), intervista, enciklopedi të shtypura dhe elektronike, udhëzime, rregullore, artikuj gazetash dhe revistash, njoftime;
- dallon dhe përdor njohuritë rreth karakteristikave të përbashkëta të teksteve, si: tema, paragrafi, fjalitë përmbyllëse, fjalori etj.;
- dallon dhe përdor njohuritë rreth mënyrës së organizimit të tekstit (*rend kronologjik, shkak dhe pasojë etj.*);
- pasuron fjalorin me fjalë dhe terminologji nga fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore (*nga tekstet që lexon*) dhe i përdor ato;
- ndan përvojat dhe kënaqësitë e leximit me shokët e shoqet e klasës;
- dallon shkakun dhe pasojën në një tekst;
- dallon problemin dhe zgjidhjen në një tekst;
- dallon faktet dhe opinionet në një tekst;
- dallon në një tekst përdorimin e argumenteve *pro* dhe *kundër* për një çështje të caktuar;
- shpjegon funksionin e *grafikëve, tabelave, pikturave* dhe *ilustrimeve*, me të cilat shoqërohen tekstet.

	<ul style="list-style-type: none"> - dallon në tekste disa elemente të stilit dhe të gjuhës, si: zgjedhja e fjalëve; përdorimi i mbiemrave; përdorimi i fjalive të ndryshme (<i>të thjeshta, të përbëra, të plota dhe mungesore</i>).
Vlerat dhe qëndrimet	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - është i motivuar për të lexuar për kënaqësi dhe informacion; - është i vëmendshëm gjatë të lexuarit; - respekton dhe pranon mendimin e tjetrit; - shfaq empati (ndjeshmëri); - respekton etikën gjatë komunikimit personal dhe në grup; - vlerëson kontributin e të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre; - shfaq vetëbesim dhe vetëvlerësim; - demonstroi vullnet dhe besim gjatë kryerjes së detyrave; - respekton gjuhën dhe kulturën e tjetrit. 	

KOMPETENCA: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Nxënësi zgjedh formën e të shkruarit (*tekstin*) në varësi të qëllimit dhe të lexuesit. Ai mbledh dhe përzgjedh informacion nga burime të ndryshme (*edhe elektronike*) për detyrën me shkrim. Nxënësi shkruan tekste koherente duke u përqendruar në temën që do të trajtojë dhe

duke lidhur logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre. Ai përdor gjuhën standarde dhe zbaton rregullat gramatikore.	
Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë	
Nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> - përdor formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit dhe zbaton rregullat gramatikore, leksikore dhe drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet e ndjenjat për tema të caktuara; - mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkuese, me fakte ose shembuj të ndryshëm. 	
Njohuritë	Shkathtësitë
Njohuritë për klasën e gjashtë <ul style="list-style-type: none"> - Dikttime. - Puna përgatitore për detyrën me shkrim. - Rishikimi i punës ose i detyrës me shkrim. Të shkruarit për qëllime personale <ul style="list-style-type: none"> - Poezi të shkurtra me pak vargje, ku nxënësit të shprehin botën e tyre emocionale (<i>në zgjedhjen e nxënësve</i>). - Rrëfime përvojash ose ngjarjesh të jetuara: rrëfime në vetën e parë, rrëfime ngjarjesh të rëndësishme në jetën e nxënësit. - Shkrimi i një tregimi të shkurtër (<i>karakterizimi i personazheve, rrëfim në vetën e parë dhe në vetën e tretë, ligjëratë e drejtë</i>). 	Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit³ <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikon qëllimin dhe lexuesin e tij, kur shkruan, si: <i>shpreh shqetësimin e tij rreth ndotjes së mjedisit, shkruan një artikull për një gazetë lokale që të bëhet i njohur për bashkëmoshatarët e tij etj.</i>; - mbledh informacionin e duhur për të shkruar duke përdorur strategji, të tilla si: <i>sheh ilustrime, pamje, piktura etj., të cilat shërbejnë si stimul (nxitje) për imagjinatën e tij; pyet për t'u sqaruar rreth temës, çështjes, subjektit; kujton njohuritë që ka rreth temës që do të shkruajë; përdor burime të ndryshme për të mbledhur informacion; studion modele të mira shkrimi që kanë trajtuar të njëjtën temë ose subjekt; mban shënime për çështje të ndryshme rreth punës me</i>

³ Këto aftësi dhe shkathtësi janë të përbashkëta për të gjitha llojet e teksteve që shkruajnë nxënësit.

<p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzime. - Njoftime. - Artikuj për gazeta. - Letra. - Urime për festa. - Ftesa. 	<p><i>shkrim;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh dhe klasifikon informacionet e mbledhura; - përdor edhe bibliotekën e shkollës ose internetin për të mbledhur informacion për punën dhe detyrat me shkrim; - zgjedh format e duhura të detyrës me shkrim në varësi të qëllimit dhe të lexuesit që ka; - mbështet mesazhin kryesor ose kyç të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose shembuj të ndryshëm;
<p>Njohuritë për klasën e shtatë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diktimit. - Rishikimi dhe redaktimi i punës me shkrim (<i>përmbajtja dhe forma</i>). <p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkrime tregimesh duke iu përmbajtur elementeve, si: personazh, dialog, fabul, mjedis, kohë. - Përshkrime personazhesh. - Kthimi i një teksti poetik në prozë. - Mbresa nga udhëtimet. <p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzime, p.sh., <i>si funksionon një lojë në kompjuter.</i> - Njoftime të shkurtra. - Shkrim në një gazetë lokale. 	<ul style="list-style-type: none"> - respekton strukturën e punës me shkrim (<i>hyrje, zhvillim, mbyllje</i>); - përdor fjalor të pasur dhe gjuhë të figurshme në shkrimet e tij, si p.sh., një larmi ndajfoljesh, mbiemrash etj., me qëllim që të ndikojë te lexuesi; - përdor gjuhën standarde gjatë të shkruarit dhe respekton rregullat gramatikore dhe ato drejtshkrimore; - shkruan tekste me dorë ose duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit; - bën ndryshime në punën me shkrim për të përmirësuar përmbajtjen, qartësinë dhe formën duke përdorur disa strategji, si: <i>ndryshon ndonjë ide ose fjali që nuk del e qartë ose shton shembuj dhe ilustrime; shton, heq, zëvendëson ose riorganizon fjalë, fraza ose fjali për ta bërë më tërheqës dhe më interesant tekstin e shkruar; shmang</i>

<ul style="list-style-type: none"> - Intervistë e shkurtër drejtuar një personi të dashur ose të pëlqyeshëm për nxënësit nga fusha e artit, sportit, kinematografisë. - Ese. 	<p style="text-align: center;"><i>gabimet drejtshkrimore dhe gabimet gramatikore.</i></p> <p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpreh me vargje të thjeshta (<i>strofa, rima</i>) ndjenjat dhe mendimet e tij; - shkruan tregime të shkurtra duke iu përmbajtur disa elementeve, si: <i>personazh, dialog, fabul, mjedis, kohë</i>; - kthen një tekst poetik në prozë; - rrëfen brendinë e një libri të preferuar për të; - përshkruan personazhet duke pasqyruar ndjenjat dhe mendimet, paraqitjen e jashtme dhe veprimet e tyre; - shkruan për ndjenjat dhe për përjetimet që i ngjall një tekst letrar, si: tregim, poezi, përrallë etj.; - krahason dy ose më shumë personazhe, ngjarje, mjedise nga një tregim, dramë etj., duke konkretizuar me shembuj nga teksti; - krahason dy ose më shumë tekste që trajtojnë të njëjtën tematikë; - përdor një gjuhë shprehëse dhe fjalor të pasur gjatë të shkruarit. <p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan shpjegime, udhëzime dhe njoftime të shkurtra; - shkruan letra formale, p.sh., <i>drejtuar stafit drejtues të shkollës ose</i>
--	--

	<p><i>përfaqësuesve të pushtetit vendor për probleme të ndryshme të shkollës, drejtuar një gazetari etj.;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan një intervistë drejtuar një personi të dashur ose të pëlqyeshëm për të nga fusha e artit, sportit, kinematografisë; - respekton formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit; - shkruan ese.
<p>Vlerat dhe qëndrimet</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit; - demonstroi imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë të shkruarit; - punon në mënyrë të pavarur; - respekton gjuhën shqipe duke shmangur fjalët e huaja gjatë të shkruarit; - respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; - vlerëson punët e të tjerëve; - bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre me shkrim. 	

KOMPETENCA: Përdorimi i drejtë i gjuhës

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Nxënësi dallon funksionet gramatikore të fjalëve. Ai gjen në fjali gjymtyrët e dyta dhe tregon se me çfarë janë shprehur: përcaktori, kallëzuesori, kundrinori, rrethanori. Nxënësi dallon fjalinë e thjeshtë nga fjalia e përbërë. Ai përcakton kategoritë gramatikore të emrit, të

mbiemrit, të foljes dhe të përemrit. Nxënësi përdor drejt shenjat e pikësimit (pikëçuditjen, trepikëshin, presjen), zanoren *e*, zanoren *ë*, grupet e zanoreve dhe diftongjeve *-ie-* dhe *-je-*. Ai demonstroi njohuri, aftësi dhe qëndrime rreth fushës leksikore, familjes së fjalëve, kuptimit të parë të fjalës, kuptimit të figurshëm të fjalës, fjalëve me shumë kuptime, sinonimeve, antonimeve, homonimeve dhe dialekteve të gjuhës shqipe.

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- dallon dhe përdor fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra si dhe përcakton llojin e tyre;
- dallon funksionet gramatikore të fjalëve në fjali;
- përcakton klasat e fjalëve dhe kategoritë gramatikore të tyre;
- dallon mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe;
- dallon fushën leksikore, familjen e fjalëve, si dhe kuptimin e parë dhe kuptimet e tjera të fjalës;
- përdor mirë gjuhën standarde shqipe.

Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës

Njohuritë	Shkathtësitë
<p>Njohuritë për klasën e gjashtë</p> <p>SINTAKSË</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fjalja e thjeshtë dhe fjalja e përbërë. - Gjymtyrët kryesore të fjalisë së thjeshtë. - Gjymtyrët e dyta të fjalisë. - Përcaktori, llojet e tij. - Ndajshtimi si një lloj përcaktori. 	<p>a) Sintaksë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon fjalinë e thjeshtë dhe fjalinë e përbërë; - përcakton funksionet gramatikore të fjalëve në një fjali; - përcakton në fjali kryefjalën e shprehur me emër, përemër, numëror, grup emëror etj.; - dallon përshtatjen e kallëzuesit me kryefjalën;

- Kundrinori, me se shprehet.

- Rrethanori, me se shprehet.

MORFOLOGJI

- Klasat e fjalëve.

Emri

- Emri dhe kategoritë gramatikore të tij (gjinia asnjane, shumësi i emrave, kuptimet e rasave).

Përemri

- Llojet e përemrave.

Foljet

- Mënyra dëftore dhe zgjedhimi i foljeve në kohët e saj.

- Mënyrën lidhore dhe zgjedhimi i foljeve në kohët e saj.

Lidhëzat

- Lidhëzat bashkërenditëse, llojet.

- Lidhëzat nënrenditëse.

Parafjalët

- Parafjalët sipas rasave.

Ndajfoljet

- Llojet e ndajfoljeve

FJALËFORMIM

- Fjala dhe pjesët përbërëse të saj (rrënja, tema, parashtesa,

- përcakton në fjali kallëzuesin;

- përcakton llojin e kallëzuesit (kallëzues i thjeshtë apo kallëzues i përbërë);

- gjen llojet e përcaktorit dhe mënyrat e shprehjes së tij;

- argumenton pse një gjymtyrë është përcaktor;

- gjen dhe përdor në fjali kundrinorin e drejtë dhe kundrinorin e zhdrejtë dhe mënyrat e shprehjes së tyre;

- argumenton pse një gjymtyrë është kundrinor i drejtë ose kundrinor i zhdrejtë;

- gjen dhe përdor në fjali rrethanorin e vendit dhe rrethanorin e kohës dhe mënyrat e shprehjes së tyre;

- gjen dhe përdor në fjali rrethanorin e shkakut dhe rrethanorin e qëllimit dhe mënyrat e shprehjes së tyre;

- gjen dhe përdor në fjali rrethanorin e mënyrës dhe rrethanorin e sasisë dhe mënyrat e shprehjes së tyre;

- argumenton pse një gjymtyrë është rrethanor vendi, kohe, shkak, qëllimi, mënyre, sasië;

- krahason fjalitë e thjeshta me fjalitë e përbëra;

- përcakton nëse fjalia është me bashkërenditje apo me nënrenditjes;

- dallon dhe ndërton fjali me bashkërenditje;

- dallon dhe përdor ligjëratën e drejtë dhe ligjëratën e zhdrejtë.

<p>prapashtesa dhe mbaresa).</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fjalët e prejardhura. - Parashtesat dhe prapashtesat që krijojnë fjalë të prejardhura. <p>DREJTSHKRIM</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe (titujt e librave, të revistave, të gazetave etj.). - Drejtshkrimi i fjalëve që e kanë zanoren <i>e</i> në pozicione të ndryshme. - Drejtshkrimi i fjalëve që e kanë shkronjën <i>ë</i> në pozicione të ndryshme. - Drejtshkrimi i lidhëzave. - Drejtshkrimi i parafjalëve. - Drejtshkrimi i ndajfoljeve. <p>LEKSIKOLOGJI DHE SEMANTIË</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fusha leksikore e fjalëve (njohuri të përgjithshme). - Familja e fjalëve (njohuri të përgjithshme). 	<p>b) Morfologji</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton klasat e fjalëve; - klasifikon fjalët në fjalë të ndryshueshme dhe fjalë të pandryshueshme; - analizon emrin në kategoritë gramatikore të tij: gjini, numër, rasë dhe shquarsi-pashquarsi; - përcakton lakimin e emrave; - dallon mbiemrin dhe kategoritë gramatikore të tij; - tregon përshtatjen e emrit me mbiemrin; - përcakton shkallët e mbiemrit; - përcakton zgjedhimin e foljes; - zgjedhon foljet në mënyrën dëftore, në mënyrën lidhore dhe në formën joveprore; - zgjedhon foljen në mënyrën kushtore, në mënyrën habitore, në mënyrën dëshirore dhe në mënyrën urdhërore; - dallon dhe përdor në fjali pjesoren dhe format e tjera të pashtjelluara të foljes; - dallon dhe përdor në fjali foljet gjysmëndihmëse; - dallon dhe lakon përemrat; - dallon dhe analizon trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit
<p>Njohuritë për klasën e shtatë</p> <p>SINTAKSË</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryefjala e shprehur me emër, përemër, numëror, grup emëror etj. - Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën. 	

- Kallëzuesi i thjeshtë dhe kallëzuesi i përbërë.
- Kundrinori i drejtë dhe i kundrinori i zhdrejtë dhe mënyrat e shprehjes së tyre.
- Rrethanori i vendit dhe rrethanori i kohës dhe mënyrat e shprehjes së tyre.
- Rrethanori i shkakut dhe rrethanori i qëllimit dhe mënyrat e shprehjes së tyre.
- Rrethanori i mënyrës dhe rrethanori i sasisë dhe mënyrat e shprehjes së tyre.
- Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe fjalitë e përbëra me nënrenditje.
- Fjalitë me bashkërenditje, llojet e tyre: shtuese, kundërshtuese, veçuese, përmbyllëse.
- Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë.

MORFOLOGJI

- Klasat e fjalëve.
- Fjalë të ndryshueshme dhe fjalë të pandryshueshme.

Emri

- Emrat dygjinishëm.
- Lakimi i emrave.

Mbiemri

vetor;

- dallon dhe përdor lidhëzat, si dhe llojet e tyre;
- dallon dhe përdor pjesëzat;
- dallon dhe përdor pasthirrmat.

c) Fjalëformim

Nxënësi:

- përcakton mënyrat fjalëformimit të fjalëve në gjuhën shqipe;
- dallon, përdor dhe krijon fjalë të prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.

ç) Drejtshkrim

Nxënësi:

- përdor drejt pikën, presjen dhe pikëçuditjen në llojet e ndryshme të fjalive;
- përdor trepikëshin, kur intonacioni i fjalisë është i pambaruar;
- shkruan drejt zanoren ë në trup të fjalës;
- shkruan drejt fjalët që kanë grupe zanoresh dhe diftongje **-ie** dhe **-je**;
- shkruan drejt emrat që kanë dy trajta shumësi sipas kuptimit të ndryshëm të tyre;
- shkruan drejt fjalët e prejardhura me prapashtesat **-si**, **-ri**, **-ar**, **-tar**, **-tor**, **-shëm** etj.;

<ul style="list-style-type: none"> - Përshtatja e mbiemrit me emrin që shoqëron. - Shkallët e mbiemrit. <p>Folja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zgjedhimi i foljeve në mënyrën dëftore, në mënyrën lidhore, forma joveprore. - Zgjedhimi i foljeve në mënyrën kushtore, në mënyrën habitore, në mënyrën dëshirore dhe në mënyrën urdhërore. - Foljet gjysmëndihmëse. <p>Format e pashtjelluara</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesorja dhe format e tjera të pashtjelluara të foljes. <p>Përemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përemri vetvetor. - Përemri dëftor. - Përemri pyetës. - Trajtat e shkurtra dhe trajtat e shkurtra të bashkuara të përemrit vetor. <p>Lidhëza</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lidhëzat dhe llojet e tyre. - Lidhëzat nënrenditëse, llojet. <p>Pasthirrma</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pasthirrmat. 	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan drejt fjalët e përbëra, kur pjesa e dytë e tyre fillon me zanore; - shkruan drejt fjalët e përngjitura. <p>d) Leksikologji dhe semantikë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton fushën leksikore të fjalëve; - krijon familje fjalësh; - dallon dhe përdor në fjali kuptimin e parë dhe kuptimin e figurshëm të fjalëve; - dallon dhe përdor në fjali fjalët me shumë kuptime; - gjen e krahason llojet e sinonimeve, antonimeve dhe homonimeve. - përdor fjalorët për interesa mësimore.
--	---

Pjesëza

- Pjesëzat.

FJALËFORMIM

- Mënyrat e fjalëformimit në gjuhën shqipe.
- Fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.

DREJTSHKRIM

- Përdorimi i pikës, presjes dhe pikëçuditjes në llojet e ndryshme të fjalive.
- Përdorimi i trepikëshit, kur intonacioni i fjalisë është i pambaruar.
- Përdorimi i apostrofit tek trajtat e shkurtra dhe ato të bashkuara.
- Drejtshkrimi i zanores ë në trup të fjalës.
- Drejtshkrimi i fjalëve që kanë grupe zanoresh dhe diftongjet *-ie-* dhe *-je*.
- Drejtshkrimi i emrave që kanë dy trajta shumësi sipas kuptimit të ndryshëm të tyre.
- Drejtshkrimi i fjalëve të prejardhura me prapashtesat *-si*, *-ri*, *-ar*, *-tar*, *-tor*, *-shëm* etj.

- Drejtshkrimi i fjalëve të përbëra, kur tema e dytë e tyre fillon me zanore.

- Drejtshkrimi i fjalëve të përngjitura.

LEKSIKOLOGJI DHE SEMANTIKË

- Fusha leksikore dhe fusha semantike.

- Llojet e sinonimeve, antonimeve dhe homonimeve.

- Fjalët shqipe dhe fjalët e huaja.

Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- vlerëson pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;

- respekton diversitetin gjuhësor mes njerëzve;

- shfaq shpirt krijues në përdorimin e gjuhës;

- shmang fjalët e huaja të panevojshme gjatë komunikimit.

- vlerëson punët e të tjerëve;

- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.

SHKALLA IV

KLASAT VIII - IX

KOMPETENCA: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Gjatë kësaj shkalle, nxënësi shfaq vëmendje, interes dhe empati (ndjeshmëri) gjatë të dëgjuarit. Ai merr pjesë në veprimtari dhe në situata praktike, ku dëgjon tekste nga fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore. Nxënësi, gjithashtu, përdor strategjitë e duhura për të kuptuar tekstin; interpreton, analizon dhe vlerëson tekstin; gjykon për qëllimin dhe ndjenjat e folësit, si dhe dallon vërtetësinë ose besueshmërinë e tekstit.

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- kupton, interpreton tekstin dhe nëntekstin, si edhe gjykon për qëllimin, ndjenjat e folësit, vërtetësinë dhe besueshmërinë e tekstit;
- diskuton, zgjeron dhe gjykon idetë e dëgjuara, si dhe merr pjesë në veprimtari praktike, ku dëgjon rreth temave të fushave të ndryshme.

Njohuritë

Njohuritë për klasën e tetë

Gjatë orëve mësimore të sugjeruara në program, nxënësi dëgjon dhe punon (ritregon, interpreton, analizon, vlerëson) me tekste (të plota ose fragmente) të cilat janë të përshtatshme për moshën e tij, si p.sh.:

Shkathtësitë

Rregullat e të dëgjuarit

Nxënësi:

- shfaq qëndrime dhe sjellje të përshtatshme gjatë të dëgjuarit, si p.sh.:
 - ☞ tregon interes gjatë një diskutimi në klasë duke drejtuar pyetje,

<ul style="list-style-type: none"> - biografi; - udhëpërshkrim; - intervistë; - reklamë; - tekste letrare të ndryshme. <p>Nxënësi, gjithashtu, merr njohuri, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qëndrimet dhe sjelljet e përshtatshme gjatë të dëgjuarit. <p>Shënim. Punohen materiale ose tekste të ndryshme që lidhen me situata dhe çështje aktuale dhe shoqërore, me shembuj konkretë dhe jetësorë që japin informacion dhe nxisin debatin mes nxënësve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ tregon vëmendje dhe interes gjatë prezantimit të një projekti të shokëve dhe të shoqeve të klasës ose gjatë ndjekjes së një shfaqjeje, ☞ shfaq empati (ndjeshmëri) ndaj të tjerëve, ☞ përdor gjuhën e trupit, kontaktin me sy dhe mimikën e duhur të fytyrës që të mos japë mesazhe negative të folësi. <p>Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të vlerësuar tekstin</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor strategji të ndryshme para, gjatë dhe pas dëgjimit për të kuptuar tekstin, si p.sh.: ☞ lexon paraprakisht informacion, në mënyrë që të mos ketë vështirësi për të kuptuar një prezantim për një çështje të caktuar, ☞ mban shënime për detajet e rëndësishme, ☞ përmbledh idetë kryesore, pasi ka dëgjuar një tekst, për të vetëkontrolluar nëse e ka kuptuar tekstin etj.;
<p>Njohuritë për klasën e nëntë</p> <p>Gjatë orëve mësimore të sugjeruara në program, nxënësi dëgjon dhe punon (<i>tregon brendinë, interpreton, analizon, vlerëson</i>) me tekste të plota ose fragmente, të cilat janë të përshtatshme për moshën e tij, si p.sh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> - rrëfim personal; - kronikë; - fjalim; - udhëzim; - tekste letrare të ndryshme (poezi, prozë ose dramë) etj. 	<ul style="list-style-type: none"> - tregon shkurtimisht brendinë ose përmbajtjen e tekstit që dëgjon, duke e ilustruar me detaje nga teksti; - interpreton informacionin që e merr nga burime të ndryshme, si: televizion, faqe interneti etj.; - mbështet interpretimet e tij me shembuj, ide dhe detaje nga teksti që dëgjon; - analizon tekstin (formën dhe përmbajtjen) që dëgjon;

<p>Nxënësi, gjithashtu, merr njohuri, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi i dëgjuesit të një teksti (<i>Kujt i drejtohet teksti?</i>). - Dallimi i vërtetësisë së një teksti. <p>Shënim. Punohen materiale ose tekste të ndryshme që lidhen me situata dhe çështje aktuale dhe shoqërore, me shembuj konkretë dhe jetësorë që japin informacion dhe nxisin debatin mes nxënësve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - përcakton argumentet kryesore të një teksti me fjalët e tij; - klasifikon detajet; - bën dallimin mes shkakut dhe pasojës; - dallon problemin dhe zgjidhjen në një tekst; - zgjeron ose lidh informacionin që dëgjon me përvojat e tij ose me njohuritë e marra nga tekste të tjera, si p.sh.: ndan opinionin e tij rreth një libri pasi ka dëgjuar idetë dhe opinionin e të tjerëve, heton rreth temës ose çështjes që dëgjon duke kërkuar informacion në burime online për të zgjeruar të kuptuarit; - krahason informacionet që dëgjon me njohuritë e mëparshme; - dallon dhe diskuton për pikëpamjet e ndryshme në një tekst; - përcakton se kujt i drejtohet folësi (audiencia e synuar) dhe tregon se si do të ndryshonte gjuha ose mesazhi, nëse do të ndryshonte dëgjuesi; - gjykon rreth vërtetësisë së tekstit duke u përqendruar te burimet dhe faktet të cilave iu referohet folësi ose autori, te përvoja e folësit, si dhe te qëllimet dhe pasionet e tij; - dallon se për çfarë shërbejnë disa strategji të përdorura gjatë prezantimeve të ndryshme, si p.sh.: <ul style="list-style-type: none"> ☞ tregon se përdorimi i listave ose tabelave e bën më të besueshëm dhe më bindës prezantimin, ☞ dallon se si një aktor e ndryshon zërin ose intonacionin e tij që të
---	--

	<p>ngjallë vëmendjen e dëgjuesit,</p> <p>☞ vlerëson një hyrje interesante të prezantimit, si një gjetje për të siguruar që në fillim vëmendjen e të tjerëve.</p>
Vlerat dhe qëndrimet	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi vullnet gjatë kryerjes së detyrave; - shfaq tolerancë dhe respekt për gjuhën dhe kulturën e tjetrit. 	

KOMPETENCA: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

<p>Përshkrimi i tematikave të kompetencës</p> <p>Gjatë kësaj shkalle, nxënësi mbron mendimet e tij, nxjerr përfundime pas vëzhgimeve të ndryshme dhe përmbledh idetë kryesore në prezantime të ndryshme. Ai kontribuon në diskutime që bëhen në grupe të vogla dhe të mëdha (në situata formale dhe joformale), pranon dhe vlerëson idetë e të tjerëve, si dhe merr parasysh elementet e gjuhës së gjesteve gjatë prezantimit.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - flet qartë dhe kuptueshëm për tema të ndryshme në situata formale dhe joformale; - përfshihet në diskutime, parafrazon e përmbledh komentet e prezantuara me gojë, duke marrë parasysh edhe elementet e gjuhës së gjesteve në një prezantim; - krijon tekste mediatike për qëllime dhe audienca të ndryshme duke përdorur format dhe teknikat e përshtatshme.

Njohuritë	Shkathtësitë
<p>Njohuritë për klasën e tetë</p> <p>Gjatë këtyre orëve, nxënësit flasin dhe diskutojnë në situata të ndryshme dhe rreth tematikave nga veprimtaria e tyre e përditshme. Këto tematika nxitin gjithëpërfshirjen e nxënësve dhe krijojnë mundësi që ata të diskutojnë në grupe të vogla dhe të mëdha. Gjithashtu, nxënësit marrin njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rrjedhshmëria, intonacioni dhe ritmi i të folurit. - Përshtatja e të folurit me qëllimin, situatën dhe dëgjuesin. - Tiparet e gjuhës së folur, si dhe dallimet mes gjuhës së folur dhe asaj të shkruar, si: llojet e fjalive (<i>të thjeshta dhe të përbëra</i>), regjistri etj. - Prezantimet, llojet dhe përgatitja e tyre. 	<p>Rregullat dhe organizimi i të folurit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - flet me diksion të qartë, rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur; - përdor pauzat (pushimet) ose ndryshon ritmin gjatë të folurit për të nxjerrë në pah ose për të theksuar një ide; - flet për qëllime dhe në situata të ndryshme dhe përshtat gjuhën me dëgjuesit, si p.sh.: tregon një histori në një klasë të ciklit të ulët, merr pjesë në një debat për një çështje sociale etj.; - flet në mënyrë koherente në varësi të qëllimit, dëgjuesit dhe temës ose subjektit, si p.sh.: jep ngjarjet sipas rendit kronologjik, kombinon logjikën me emocionet në një fjalim të shkurtër etj.; - përzgjedh fjalët dhe terminologjinë e duhur për të arritur qëllimin e tij dhe për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit; - përdor shprehje frazeologjike, shprehje të figurshme dhe fjalë të urta gjatë të folurit: - shpreh ndjenjë dhe emocion gjatë të treguarit; - kontrollon përdorimin e gjesteve gjatë të folurit, në mënyrë që dëgjuesi të mos shmangë vëmendjen nga mesazhi; - përdor gjuhën standarde gjatë të folurit; - shmang gjatë të folurit përdorimet pavend të fjalëve dhe të formave
<p>Njohuritë për klasën e nëntë</p> <p>Gjatë këtyre orëve nxënësit flasin dhe diskutojnë në situata të ndryshme dhe rreth tematikave nga veprimtaria e tyre përditshme. Këto tematika nxitin gjithëpërfshirjen e nxënësve dhe krijojnë mundësi që ata të diskutojnë në grupe të vogla dhe të mëdha. Gjithashtu, nxënësit marrin njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Elementet e komunikimit joverbal dhe rëndësia e tyre gjatë të folurit. 	

<ul style="list-style-type: none"> - Rëndësia e përdorimit të gjuhës standarde gjatë të folurit. - Organizimi i një diskutimi ose i një debati. 	<p>gjuhësore që e dëmtojnë gjuhën shqipe;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit gjatë prezantimit të një projekti ose detyre në grup. <p>Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton dhe ndjek rregullat gjatë diskutimit në grup; - ndan rolet gjatë diskutimeve ose debateve; - praktikon teknika, të tilla si: vendosja e minutave për folësin, afate për të marrë vendime etj.; - ndan detyrat gjatë diskutimeve në klasë, në mënyrë që të zhvillojnë një projekt së bashku <i>(një nxënës ndihmon duke bërë një listë të ftuarish nga komuniteti të cilët mund të vijnë në klasë dhe të rrëfejnë për profesionin dhe punën që bëjnë, një tjetër harton një listë pyetjesh që do t'u drejtohen të ftuarve etj.);</i> - bashkëbisedon lirshëm duke dhënë mendimet dhe këndvështrimet e tij, si dhe duke respektuar edhe mendimet dhe gjykimet e të tjerëve; - shpreh mendimet dhe këndvështrimet e tij, duke respektuar edhe faktorin kohë; - mban qëndrim, vlerëson dhe jep ndihmesë në situata mosmarrëveshjesh; - pasuron linjën e debatit me argumente duke respektuar etikën;
---	--

	<ul style="list-style-type: none"> - përmbledh informacionin që prezantohet gjatë diskutimeve në klasë, në shkollë dhe jashtë saj dhe harton një raport.
Vlerat dhe qëndrimet	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - është korrekt në komunikim; - shfaq vetëbesim dhe vetëvlerësim gjatë kryerjes së detyrave të ndryshme; - demonstroi vullnet gjatë kryerjes së detyrave; - shfaq tolerancë dhe respekt për kulturën dhe gjuhën e tjetrit; - demonstroi imagjinatë dhe mendim krijues për zgjidhjen e problemeve; - përfshihet në mënyrë aktive në punë individuale dhe në grup; - demonstroi pavarësi në vendimmarrje dhe në veprime; - tregon kureshtje për hulumtim dhe kërkim. 	

KOMPETENCA: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Gjatë kësaj shkalle, nxënësi zhvillon njohuritë dhe aftësitë për të kuptuar, për të analizuar dhe për të vlerësuar tekste të ndryshme, si: reportazhe, kronika, biografi, kujtime, udhëpërshkrime, intervista, rregullore, përmbledhje, shkresa, artikuj gazetash dhe revistash, reklama, ese të ndryshme dhe fjalime.

Nxënësi lexon dhe punon me tekste nga krijimtaria popullore gojore, nga letërsia shqipe dhe ajo botërore, si dhe nga periudha e gjini të ndryshme; përshkruan dhe diskuton për kohën, vendin, mjedisin dhe ngjarjet duke dhënë detaje nga teksti; veçon temën kryesore ose motivet. Ai analizon personazhet, dallon dhe shpjegon figurat letrare, si dhe gjykon e vlerëson elemente të formës dhe të përmbajtjes së një teksti letrar.

Nxënësi dallon motivet dhe elementet e metrikës në një tekst poetik, diskuton rreth atmosferës që krijon ai, analizon dhe shpjegon funksionin e elementeve të stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik, krahason poezinë lirike me poezinë epike. Ai njeh dhe dallon disa lloje të teksteve poetike, si: balada, soneti, himni, elegjia etj.

Nxënësi lexon lloje të ndryshme të prozës, dallon temën dhe motivet, përshkruan me detaje nga teksti fabulën dhe subjektin e një proze. Ai përcakton tipare të disa teksteve në prozë, si: tregimi, novela, romani. Ai dallon rrëfimitarin, vetën dhe kohën e rrëfimit në një tekst në prozë.

Nxënësi studion fragmente dhe vepra të ndryshme dramatike, përcakton tiparet kryesore të tragjedisë, komedisë dhe dramës, tregon rolin që kanë personazhet në veprat dramatike, analizon tiparet e personazheve dhe tregon funksionet e elementeve të veçanta të dramës.

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- kupton tekstin edhe kur mendimet dhe idetë nuk jepen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shpjegon se si gjuha dhe stili i autorit ndikojnë për t'i dhënë idetë në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar;
- analizon dhe diskuton për interpretimet e të tjerëve rreth tekstit.

a) Tekste letrare

<ul style="list-style-type: none"> - vlerëson gjuhën dhe idetë që përcjell autori në tekst, analizon sjelljen dhe qëndrimet e personazheve, zhvillimin e fabulës ose subjektit; - bën dallimin mes personazhit, autorit dhe tregimtarit; - krahason stilin, gjuhën dhe tematikën në tekste të ndryshme. <p>b) Tekste joletrare</p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh, krahason dhe përmbledh informacionin nga tekste të ndryshme; - dallon informacionin e rëndësishëm nga i parëndësishmi, faktin nga opinioni, shkakun nga pasoja; - veçon tiparet karakteristike të fjalëve, fjalive dhe tekstit në tekste të ndryshme. 	
Njohuritë	Shkathtësitë
<p>Njohuritë për klasën e tetë</p> <p>Studim tekstesh letrare: Nxënësi punon (<i>njeh, kupton, interpreton, analizon, gjykon dhe vlerëson</i>) me tekste poetike, tekste në prozë dhe tekste dramatike nga letërsia shqipe, nga letërsia botërore, si dhe nga krijimtaria popullore gojore. Gjatë këtyre orëve, nxënësit marrin edhe njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tema dhe motivet. - Figuracioni letrar: epiteti, personifikimi, metafora, krahasimi, hiperbola, alegoria, antiteza. - Momentet kryesore të jetës dhe të veprës së autorëve nga 	<p>Të lexuarit për të kuptuar tekstin⁴</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh tekstet që lexon në varësi të qëllimit që ka, si p.sh.: lexon dy reportazhe të ndryshme që të krahasojë mënyrën se si e trajtojnë një problem social, lexon dy artikuj gazetash që trajtojnë të njëjtën tematikë ose të njëjtën çështje dhe shikon ku gazetarët bashkohen dhe ku ndryshojnë nga njëri-tjetri; - përdor strategji të ndryshme para, gjatë dhe pas leximit, si p.sh.: <ul style="list-style-type: none"> ☞ njihet paraprakisht me tiparet e formës dhe të strukturës së një lloji teksti, në mënyrë që ta ketë më të lehtë për ta kuptuar një tekst të

⁴ Këto aftësi dhe shkathtësi janë të përbashkëta për tekstet letrare dhe joletrare.

janë shkëputur fragmentet ose tekstet e përfshira në tekstin shkollor, si dhe vendi që zënë në letërsinë shqipe ose botërore (shkurtimisht).

Teksti poetik:

- Motivët në një tekst poetik.
- Tiparet e metrikës në poezi (lloji i vargut, i rimës dhe i strofës).
- Tiparet kryesore të disa teksteve poetike, si: këngë legjendare, sonet etj.
- Lidhja e poezisë lirike me muzikën, pikturën dhe artet e tjera.

Tekst në prozë:

- Tema dhe motivët.
- Tiparet e disa teksteve në prozë, si: tregimi, novela dhe romani, përralla etj.
- Analiza e personazhit.

Tekst dramatik:

- Tiparet e ndryshme të tragjedisë, komedisë dhe dramës.
- Roli i personazheve në veprat dramatike.
- Ngjashmëritë dhe dallimet mes një filmi, një tregimi ose një romani dhe një drame.

Studim tekstesh jo letrare: Nxënësit punojnë (*kuptojnë*,

caktuar,

- ☞ praktikon rileximin për të ngulitur në mendje detajet më të rëndësishme,
- ☞ përqendrohet tek ilustrimet e tekstit për të plotësuar dhe për të zgjeruar informacionin e tekstit,
- ☞ mban shënime gjatë të lexuarit,
- ☞ përdor një organizues grafik për të shënuar faktet dhe idetë e rëndësishme;
- lexon pjesë-pjesë tekstin dhe parashikon rreth brendisë, personazheve, ngjarjeve etj. (*lexim i drejtuar*);
- interpreton tekstet dhe jep argumente dhe shembuj që mbështesin interpretimin e tij;
- zgjeron kuptimin mbi tekstet duke lidhur idetë në to me idetë dhe njohuritë e tij, si p.sh., përcakton nëse informacioni në një artikull përkon ose kundërshton njohuritë e tij ose përvojat e tij të mëparshme;
- dallon faktin nga opinioni;
- dallon shkakun nga pasoja;
- dallon problemin dhe zgjidhjen e problemit;
- gjykon për vlerat e një teksti duke përdorur ilustrime dhe detaje nga teksti, si p.sh.: dallon që detajet e bëjnë një histori të duket e besueshme dhe e vërtetë, dallon që rima ose aliteracioni në një reklamë

<p><i>interpretojnë, analizojnë, krahasojnë, sintetizojnë, vlerësojnë</i>) me tekste nga kultura dhe periudha të ndryshme, elektronike dhe të shtypura, si: biografi, kujtime, intervista, rregullore, përmbledhje, lajme, reportazhe, kronika, ese të ndryshme, reklama etj.</p> <p>Gjatë studimit të këtyre teksteve, nxënësit marrin edhe njohuri, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tiparet kryesore të teksteve. - Fakti dhe opinioni. - Argumentet <i>pro</i> dhe <i>kundër</i> një çështjeje në një tekst. 	<p>bën që të mbahet mend lehtë nga konsumatorët etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> - nxjerr përfundime pasi ka lexuar dhe ka kuptuar një tekst; - gjen funksionin e disa elementeve të formës të tekstit, si p.sh., rrëfimi në vetën e parë në një libër me kujtime ose përshkrimi linear dhe episodik në një udhëpërshkrim; - përcakton funksionin e disa elementeve të teksteve, si p.sh.: ilustrimet në librat për fëmijë të vegjël ose shkrimet në përmasa të ndryshme plotësojnë vështirësitë e tyre në lexim; ngjyrat, fotografitë, titujt dhe nëntitujt në faqen e parë të një gazete tërheqin vëmendjen e lexuesit për ta marrë dhe për ta lexuar atë etj.; - diskuton rreth këndvështrimeve të ndryshme në një tekst dhe shfaq mendimet e tij; - vlerëson idetë që përcjell teksti, gjuhën e stilin e autorit, duke argumentuar mendimin e tij; - diskuton se si ndikon teksti tek ai, në botën emocionale ose në ndjesitë e tij; - përdor mënyra të ndryshme për të pasuruar fjalorin e tij, si p.sh.: shënon në një fletore (<i>ose diku tjetër</i>) fjalët dhe fjalitë që i has gjatë leximit dhe që i pëlqejnë; dallon fjalët e huaja dhe i zëvendëson me fjalë shqipe (<i>kur ekziston fjala përgjegjëse në gjuhën shqipe</i>) etj.
<p>Njohuritë për klasën e nëntë</p> <p>Studim tekstesh letrare: Nxënësi punon (<i>njeh, kupton, interpreton, analizon, gjykon, vlerëson</i>) me tekste poetike, tekste në prozë dhe tekste dramatike nga letërsia shqipe, nga letërsia botërore, si dhe nga krijimtaria popullore gojore. Gjatë këtyre orëve, nxënësit marrin edhe njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinitë letrare dhe tiparet kryesore të tyre. - Figuracioni letrar. - Elementet kryesore e stilit dhe të gjuhës. - Momentet kryesore (dy-tri) të jetës dhe të veprës së autorëve nga janë shkëputur fragmentet ose tekstet e 	<p>Të lexuarit e teksteve letrare</p>

<p>përfshira në tekst shkollor, si dhe vendi që zënë në letërsinë shqipe ose botërore.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lidhja e letërsisë me artet: muzika, piktura, skulptura, koreografia, filmi etj. <p>49 orë mësimore për tekstet letrare sugjerohen të ndahen shpërndahen si më poshtë.</p> <p>Tekst poetik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rima dhe strofat në një tekst poetik. - Vargu i lirë në një poezi. - Elementet e stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik, si p.sh.: <ul style="list-style-type: none"> ☞ zgjedhja e fjalëve; ☞ përdorimi i fjalëve të reja; ☞ përdorimi i figurave letrare mbizotëruese. - Tiparet e poezisë lirike. - Tiparet e poezisë epike (<i>p.sh., Cikli i Kreshnikëve</i>). - Proza poetike. <p>Tekst në prozë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Subjekti i një proze. - Tiparet kryesore të disa teksteve në prozë (tregimi, novela, romani). - Analiza e personazhit (edhe psikologjike). 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon rrjedhshëm lloje të ndryshme tekstesh letrare nga krijimtaria popullore, nga shkrimtarë përfaqësues të letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme; - grupon tekstet që lexon sipas gjinive dhe llojeve letrare; - përshkruan dhe diskuton për kohën, vendin, mjedisin dhe ngjarjet, duke dhënë detaje nga teksti; - dallon dhe shpjegon funksionin e epitetit, personifikimit, metaforës, krahasimit, hiperbolës, alegorisë, inversionit, antitezës; - gjen në tekst figurat tingullore, si aliteracion, asonancë e konsonancë, dhe shpjegon funksionin e tyre. <p>a) Tekst poetik</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon me shprehësi lloje të ndryshme tekstesh poetike; - diskuton rreth atmosferës që krijon poezia; - dallon motivet në një tekst poetik; - dallon tiparet e metrikës në poezi (lloji i vargut, i rimës dhe i strofës); - dallon vargun e lirë në një poezi; - analizon dhe shpjegon funksionin e elementeve të stilit dhe të gjuhës në një tekst poetik, si p.sh.: <ul style="list-style-type: none"> ☞ zgjedhja e fjalëve,
---	--

- Rrëfimtari, veta dhe koha e rrëfimit.

Tekst dramatik:

- Elementet e strukturës së një teksti dramatik, si: skena, aktet, personazhet, fjalët e personazheve, didaskalitë.
- Monologu, dialogët në një tekst dramatik.
- Vënia në skenë (*në bashkëpunim me mësuesin dhe me shokët e shoqet e klasës*) e një teksti dramatik, duke ndarë rolet: regjisori, aktorët, skenografët, kostumografët etj.

Studim tekstesh joletrare:

Nxënësit punojnë (*kuptojnë, interpretojnë, analizojnë, krahasojnë, sintetizojnë, vlerësojnë*) me tekste nga kultura dhe periudha të ndryshme, elektronike dhe të shtypura, si: reportazhe, kronika, biografi, kujtime, udhëpërshkrime, intervista, rregullore, artikuj gazetash dhe revistash, ese të ndryshme etj.

Gjatë studimit të këtyre teksteve, nxënësit marrin edhe njohuri, si:

- Tiparet e teksteve të mësipërme (ese, biografi, kronika, udhëpërshkrime).
- Dallimet kryesore mes një teksti letrar dhe një teksti joletrar.

☞ përdorimi i fjalëve të reja,

☞ përdorimi i figurave letrare mbizotëruese;

- dallojnë tiparet kryesore të poezisë lirike;
- dallon tiparet kryesore të poezisë epike (*Cikli i Kreshnikëve*);
- krahason poezinë lirike me poezinë epike;
- njeh dhe dallon disa lloje të teksteve poetike, si soneti, himni, elegjia etj., si dhe tiparet kryesore të tyre;
- përcakton disa tipare të sonetit, himnit, elegjisë etj.;
- krahason poezinë me prozën poetike;
- krahason poezinë lirike me muzikën e me pikturën;
- mëson përmendsh poezi dhe i reciton ato.

b) Tekst në prozë

Nxënësi:

- lexon lloje të ndryshme të prozës;
- përshkruan me detaje nga teksti subjektin e një proze;
- dallon temën;
- përcakton tiparet e disa teksteve në prozë, si: tregimi, novela, romani, përralla etj., si p.sh:
- ☞ *fabulat* (personazhet, personifikimi, alegoria, morali i fabulës),
- ☞ *përrallat* (elementet fantastike, numërorët: 3, 7, 9, 12, formulat e hyrjes dhe mbylljes, personazhet joreale, formulat e magjisë, fundi i

	<p>lumtur, hiperbola etj.);</p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon personazhet, duke u përqendruar: <ul style="list-style-type: none"> ☞ te fjalët përshkruese të autorit për personazhin, ☞ te fjalët, veprimet, mendimet e tij, ☞ te marrëdhëniet me personazhet e tjera; - sjell përvojat e tij të ngjashme me ato të personazheve të një tregimi, përralle, drame etj.; - dallon mënyrën e rrëfimit në një tregim, novelë, roman etj., si p.sh.: rrëfim në formën e një letre, një ditari; rrëfim nga një këndvështrim i caktuar; rrëfim duke i dhënë ngjarjet në rend kronologjik ose kohor etj.; - dallon rrëfimtarin, vetën dhe kohën e rrëfimit. <p>c) Tekst dramatik</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon fragmente dhe vepra të ndryshme dramatike (tragjedi, komedi dhe dramë); - përcakton tipare të ndryshme të tragjedisë, të komedisë dhe të dramës, si dhe përcakton ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre; - analizon elementet e kompozicionit në një vepër dramatike; - dallon dhe analizon elementet e strukturës së një teksti dramatik, si: skena, aktet, personazhet, fjalët e personazheve, didaskalitë;
--	---

- tregon rolin që kanë personazhet në veprat dramatike;
- analizon tiparet psikologjike të personazhit letrar në bazë të ngjarjeve, të dialogut dhe të monologut;
- merr pjesë në lojë me role, duke u përqendruar te mbajtja përmendsh e tekstit, diksioni, lëvizjet e trupit, detajet shprehëse etj.;
- veçon ngjashmëritë dhe dallimet mes një filmi, një tregimi ose një romani dhe një drame;
- merr pjesë në vënien në skenë (në bashkëpunim me mësuesin dhe me shokët e shoqet e klasës) të një teksti dramatik, duke ndarë rolet: regjisori, aktorët, skenografët, kostumografët etj. (në formën e një projekti);
- mëson përmendsh dhe reciton pjesë nga tekstet dramatike, si p.sh., një monolog.

Të lexuarit e teksteve joletrare

Nxënësi:

- lexon tekste nga kultura dhe kohë të ndryshme, të shtypura dhe elektronike, si: kronika, biografi, kujtime, udhëpërshkrime, intervista, rregullore, artikuj gazetash dhe revistash, ese të ndryshme, reklama etj.;
- dallon dhe përdor njohuritë rreth elementeve të tekstit, si: tema, paragrafi, hyrja, përfundimet, citimi, indeksi, bibliografia, tabela,

	<p>harta, diagrami;</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon argumentet <i>pro</i> dhe <i>kundër</i> një çështjeje në një tekst; - dallon një tekst letrar nga një tekst joletrar, si p.sh., krahason një roman me një biografi ose autobiografi, një tregim fantastik-shkencor nga një udhëpërshkrim etj.
<p>Vlerat dhe qëndrimet</p>	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - është i motivuar për të lexuar për kënaqësi dhe informacion; - është i vëmendshëm gjatë të lexuarit; - respekton dhe pranon mendimin e tjetrit; - shfaq empati (ndjeshmëri) gjatë të lexuarit; - respekton etikën gjatë komunikimit personal dhe në grup; - vlerëson kontributin e të tjerëve gjatë kryerjes së një detyre; - shfaq vetëbesim dhe vetëvlerësim; - demonstroi vullnet gjatë kryerjes së detyrave; - respekton gjuhën dhe kulturën e tjetrit. 	

KOMPETENCA: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Nxënësi ndjek të gjithë hapat e domosdoshëm të procesit të të shkruarit (*planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi*). Ai shkruan duke zbatuar karakteristikat e formës, të përmbajtjes dhe të strukturës, tekste të tilla si: kronika, reportazhe, intervista, letra personale dhe formale, e-mail, ese, udhëzim, raport, broshurë ose fletëpalosje, CV, njoftim, ftesë, përshkrime.

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- ndjek dhe realizon hapat e domosdoshëm në procesin e të shkruarit;
- përdor forma të efektshme të të shkruarit për qëllime dhe audiencë të caktuara;
- paraqet në mënyrë të strukturuar informacionin, idenë dhe mendimet e tij duke zbatuar rregullat drejtshkrimore.

Njohuritë

Shkathtësitë

Njohuritë për klasën e tetë

- Puna paraprake për një punë ose detyrë me shkrim, si p.sh.: njohuritë e mëparshme rreth temës, diskutime (me shokët dhe shoqet) rreth temës ose llojit të shkrimit; studime të modeleve të llojit të shkrimit; mbledhje informacioni etj.
- Diktimit

Të shkruarit për qëllime personale

- Shkrimi i një poezie ose komente rreth një poezie.
- Shkrimi i një tregimi fantastik-shkencor duke u mbështetur

Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit⁵

Nxënësi:

- përcakton qëllimin, temën dhe subjektin për punët me shkrim, si p.sh., një rrëfim për një ngjarje të rëndësishme historike në krahinë e tij, i cili mund të botohet në gazetën e shkollës;
- njeh dhe zbaton në proces strategjitë e të shkruarit;
- përcakton njohuritë e mëparshme rreth temës për të cilën do të shkruajë;
- merr pjesë në një diskutim në grup për t'u sqaruar dhe për të ndarë ide

⁵ Këto aftësi dhe shkathtësi janë të përbashkëta për të gjitha llojet e teksteve që shkruajnë nxënësit.

<p>në imagjinatën e nxënësve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkrimi i një personazhi të preferuar. - Krahasime mes personazheve nga tekste të ndryshme. <p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkrimi i një broshure ose i një fletë-palosjeje për tema dhe lexues të ndryshëm (<i>zgjedhje e nxënësve</i>). - Kronikë. - Ese. 	<p>e opinione rreth temës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - mbledh informacion për punë dhe detyra me shkrim nga burime të ndryshme, të shtypura dhe elektronike, duke përdorur strategji të ndryshme, si: <ul style="list-style-type: none"> ☞ kërkon informacion në internet nëpërmjet fjalëve kyç, ☞ studion modele të mira të të shkruarit, ☞ mban shënime, ☞ klasifikon burimet e informacionit në të rëndësishme dhe dytësore, ☞ kryen intervista me specialistë që kanë njohuri për temën (kur është e mundur), ose me dëshmitarë në një ngjarje, ☞ shënon të gjitha burimet e informacionit në një listë të veprave të cituara ose referencat, ☞ përcakton nëse informacioni i mbledhur është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për detyrën e tyre dhe nëse jo, planifikon për të mbledhur informacion shtesë; - rendit dhe organizon idetë kryesore duke i ilustruar dhe duke i mbështetur me detaje, shembuj, fakte dhe opinione të ndryshme; - respekton strukturën e punës me shkrim (hyrje, zhvillim dhe mbyllje); - përshtat gjuhën me llojin e detyrës me shkrim, me qëllimin dhe me lexuesin; - përzgjedh fjalët dhe frazat që i japin punës ose detyrës me shkrim
<p>Njohuritë për klasën e nëntë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diktimit <p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkrimi i një poezie ose i një proze poetike, ose i një tregimi rreth një teme të caktuar, të përcaktuar nga mësuesi ose të zgjedhur nga vetë nxënësit. - Kthimi i një poezie në një tregim ose në prozë poetike. <p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ese. - Plan veprimtarish për ngjarje, për festa e përvjetorë të ndryshëm. - CV. - Njoftim ose ftesë formale. 	

	<p>gjallëri dhe shprehësi;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor lloje të ndryshme fjalish (lloj, gjatësi, strukturë) për të shtuar interesin e lexuesit dhe për të përmirësuar rrjedhën e punës me shkrim; - zbaton njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shkruarit; - përdor gjuhën standarde gjatë të shkruarit; - rishikon punët me shkrim për të përmirësuar përmbajtjen, organizimin, qartësinë, stilin dhe gjuhën, si p.sh.: <ul style="list-style-type: none"> ☞ shton shembuj që mbështesin idenë kryesore, ☞ heq detaje të parëndësishme, ☞ shton fjalët e duhura në hyrje të çdo paragrafi që të krijojë idenë e vazhdimësisë së mendimeve dhe lidhjen mes tyre; - shmang gabimet gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shkruarit. <p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan një poezi me rimë ose me varg të lirë për të shprehur mendimet ose ndjenjat e tij në lidhje me gjendjen shpirtërore, njerëzit ose personazhet e dashur, përvojat ose ngjarjet e rëndësishme në jetën e tij; - shkruan rrëfime personale duke përshkruar ose reflektuar mbi veten, mbi përvojat personale, ngjarjet e kaluara ose çështje personale;
--	--

- shkruan tregime nga bota reale ose imagjinare për tema që janë interesante për moshën;
- realizon shkrime komentuese për poezi të ndryshme;
- kthen me shkrim një poezi në prozë ose prozë poetike;
- përshkruan personazhet e tij të preferuara dhe argumenton pëlqimin e tij;
- krahason me shkrim personazhe nga tregime, përralla dhe fabula të ndryshme.

Të shkruarit për qëllime funksionale

Nxënësi:

- shkruan kronika për tema të ndryshme;
- shkruan intervista për figura të njohura të sportit, të kinematografisë, të shkencës, të artit, të letërsisë etj.;
- njeh dhe zbaton hapat e shkrimit të një eseje;
- shkruan plane veprimtarish për ngjarje;
- shkruan raporte të shkurtra pas një kërkimi;
- shkruan një broshurë ose një fletëpalosje për tema dhe lexues të ndryshëm (zgjedhje e nxënësve);
- shkruan një CV, duke ndjekur strukturën e shkrimit të një teksti të tillë;
- shkruan artikuj të ndryshëm për gazeta dhe revista.

Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit;
- demonstroi imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë të shkruarit;
- punon në mënyrë të pavarur;
- respekton gjuhën shqipe duke shmangur fjalët e huaja gjatë të shkruarit;
- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerëson punët e të tjerëve;
- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre me shkrim.

KOMPETENCA: Përdorimi i drejtë i gjuhës

Përshkrimi i tematikave të kompetencës

Gjatë kësaj shkalle, nxënësi demonstroi njohuri, shkathtësi dhe qëndrime: për gjymtyrët kryesore dhe të dyta, për llojet e fjalive sipas kumtimit, pohimit dhe mohimit dhe sipas gjymtyrëve kryesore, për përdorimin e ligjëratës së drejtë dhe të ligjëratës së zhdrejtë, për fjalët e ndryshueshme (kategoritë e tyre gramatikore) dhe fjalët e pandryshueshme, për stilet dhe regjistrat e gjuhës, për përbërësit e fjalës dhe mënyrat e formimit të saj. Nxënësi, gjithashtu, zbaton rregullat drejtshkrimore.

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi:

- dallon, përdor dhe analizon llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacionit, ndërtimit dhe gjymtyrëve kryesore;
- përdor dhe analizon llojet e gjymtyrëve kryesore dhe të gjymtyrëve të dyta;

<ul style="list-style-type: none"> - përdor dhe analizon klasat e fjalëve të ndryshueshme dhe të fjalëve të pandryshueshme; - analizon stilet dhe regjistrat e gjuhës; - vlerëson pasurinë leksikore të shqipes, përdor gjuhën standarde, zbaton rregullat drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimit. 	
Njohuritë, aftësitë, shkathtësitë dhe qëndrimet për realizimin e kompetencës	
Njohuritë	Shkathtësitë
Njohuritë për klasën e tetë SINTAKSË <ul style="list-style-type: none"> - Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali (kryefjalë, kallëzues, përcaktor, rrethanor, kundrinor). - Llojet e kallëzuesit: foljor dhe emëror. - Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe fjalitë e përbëra me nënrenditje. - Llojet e fjalisë së përbërë me nënrenditje: <ul style="list-style-type: none"> ☞ përcaktore, ☞ filluese, ☞ vendore, ☞ kohore, ☞ shkakore, ☞ qëllimore, ☞ mënyrore, ☞ krahasore, 	VIII SINTAKSË Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - dallon funksionet gramatikore të fjalëve në fjali (kryefjalë, kallëzues, përcaktor, rrethanor, kundrinor) dhe tregon me se shprehen; - përcakton llojet e kallëzuesit (<i>emëror, foljor</i>); - dallon fjalitë e përbëra me bashkërenditje nga fjalitë e përbëra me nënrenditje; - përcakton llojin e fjalisë së përbërë me nënrenditje: <ul style="list-style-type: none"> ☞ përcaktore, ☞ filluese, ☞ vendore, ☞ kohore, ☞ shkakore, ☞ qëllimore, ☞ mënyrore,

- ☞ kushtore,
- ☞ lejore,
- ☞ rrjedhimore,
- ☞ sasiore.

- Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë. Kthimi i ligjërates së drejtë në ligjërata të zhdrejtë (*ndryshimet që ndodhin*).

MORFOLOGJI

Emri

- Emrat që përdoren vetëm në njëjës ose vetëm në shumës.
- Emrat, si: *i ati, i biri, e motra* etj.

Mbiemri

- Kategoritë gramatikore të mbiemrit.

Përemri

- Përemri lidhor.
- Përemri pronor.

Folja

- Zgjedhimi jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore.

Ndajfolja

- Llojet e ndajfoljeve dhe shkallët e tyre.

- ☞ krahasore,
- ☞ kushtore,
- ☞ lejore,
- ☞ rrjedhimore,
- ☞ sasiore.

- dallon ligjëratën e drejtë nga ligjërata e zhdrejtë;
- kthen ligjëratën e drejtë në ligjërata të zhdrejtë dhe anasjelltas.

VIII

MORFOLOGJI

Nxënësi:

- dallon dhe përdor emrat që përdoren vetëm në numrin njëjës dhe emrat që përdoren vetëm në numrin shumës;
- dallon dhe përdor saktë emrat, si: *i ati, i biri, e motra*;
- analizon mbiemrin dhe kategoritë e tij gramatikore;
- dallon dhe përdor në fjali përemrin lidhor;
- dallon dhe përdor në fjali përemrin pronor;
- dallon dhe përdor foljet në formën joveprorë, në mënyrat: dëftore, lidhore, habitore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore;
- gjen dhe përdor ndajfoljet dhe shkallët e tyre;
- tregon se si ndryshon një ndajfolje në shkallë të ndryshme;
- dallon dhe përdor në fjali parafjalët;

<p>Parafjala</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parafjalët sipas strukturës morfologjike. <p>Lidhëza</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore sipas llojeve të tyre. <p>Pjesëza</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëzat. Klasifikimi i tyre. <p>Pasthirrma</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pasthirrmat. Klasifikimi i tyre. <p>FJALËFORMIM</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fjala dhe pjesët përbërëse të saj. - Analiza e fjalëve sipas ndërtimit dhe formimit. <p>DREJTSHKRIM</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i saktë i dy pikave, thonjëzave, pikëpresjes dhe kllapave. - Përdorimi i drejtë i bashkëtingëlloreve të zëshme në <i>fund dhe në trup të fjalës</i>. - Përdorimi i drejtë i fjalëve që fillojnë me bashkëtingëlloret <i>sh-</i>, <i>zh-</i>, <i>ç-</i> nistore. - Përdorimi i drejtë i fjalëve që fillojnë me bashkëtingëlloren <i>s-</i>, <i>z-</i> nistore. - Përdorimi i drejtë i bashkëtingëllores <i>j</i>. 	<ul style="list-style-type: none"> - dallon, klasifikon dhe përdor lidhëzat dhe shprehjet lidhëzore; - përcakton dhe përdor pjesëzat; - klasifikon pjesëzat; - dallon dhe përdor në fjali pasthirrmat. <p>FJALËFORMIM</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe analizon fjalën dhe pjesët e saj përbërëse; - analizon fjalët sipas ndërtimit dhe sipas formimit. <p>VIII</p> <p>DREJTSHKRIM</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor saktë dy pikat, thonjëzat, pikëpresjen dhe kllapat; - shkruan drejt bashkëtingëlloret e zëshme në <i>fund dhe në trup të fjalës</i>; - shkruan drejt fjalët që fillojnë me bashkëtingëlloret <i>sh-</i>, <i>zh-</i>, <i>ç-</i> nistore; - shkruan drejt fjalët që fillojnë me bashkëtingëlloren <i>s-</i>, <i>z-</i> nistore; - shkruan drejt bashkëtingëlloren <i>j</i>; - shkruan drejt bashkëtingëlloren <i>h</i>; - shkruan drejt fjalët me <i>rr</i>; - shkruan drejt <i>nj-në</i> në trup dhe në fund të fjalës;
--	--

<ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i drejtë i bashkëtingëllores <i>h</i>. - Përdorimi i drejtë i fjalëve që kanë bashkëtingëlloren <i>rr</i>. - Përdorimi i drejtë i bashkëtingëllores <i>nj</i>- në trup dhe në fund të fjalës. - Përdorimi i drejtë i grupeve të bashkëtingëlloreve <i>mb, ng, nd, ngj</i>. - Shkrimi i ligjëratës së drejtë dhe i ligjëratës së zhdrejtë. <p>LEKSIKOLOGJI DHE SEMANTIKË</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fjalët me ngjyrim emocional në një kontekst të caktuar. - Kuptimi i drejtpërdrejtë dhe kuptimi i figurshëm i fjalëve. - Regjistrat e gjuhës (njohuri të përgjithshme). - Stilet e gjuhës (njohuri të përgjithshme). - Dialektet e gjuhës shqipe dhe vlera e tyre. - Gjuha standarde, roli dhe rëndësia e përdorimit të saj. 	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan drejt grupet e bashkëtingëlloreve <i>mb, ng, nd, ngj</i>; - shkruan drejt ligjëratën e drejtë dhe ligjëratën e zhdrejtë. <p>VIII</p> <p>LEKSIKOLOGJI DHE SEMANTIKË</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon fjalët me ngjyrim emocional në një kontekst të caktuar; - përcakton kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalëve dhe kuptimin e figurshëm; - dallon dhe përdor regjistrat e gjuhës; - përcakton stilet e gjuhës së përdorur në tekste të ndryshme letrare dhe joletrare; - vlerëson pasurinë leksikore të dialekteve të shqipe; - vlerëson gjuhën standarde, rolin e saj dhe rëndësinë e dialekteve.
<p>Njohuritë për klasën e nëntë</p> <p>SINTAKSË</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjymtyrët kryesore. - Gjymtyrët e dyta (përcaktori, kundrinori, rrethanori, përcaktori kallëzuesor). - Llojet e fjalive sipas kumtimit. - Fjalitë pohore dhe fjalitë mohore 	<p>SINTAKSË</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe analizon gjymtyrët kryesore në fjali; - dallon dhe analizon gjymtyrët e dyta në fjali; - përcakton llojet e fjalisë sipas kumtimit dhe i përdor drejt ato; - përcakton fjalitë mohore dhe fjalitë pohore dhe i përdor drejt ato; - përcakton llojin e fjalive sipas gjymtyrëve kryesore dhe i përdor drejt ato;

- Fjalitë njëkryegjymtyrëshe dhe dykryegjymtyrëshe.
- Fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore.
- Fjalitë njëkryegjymtyrëshe emërore.
- Fjalitë përbëra, skemat e përziera.

MORFOLOGJI

- Fjalët e ndryshueshme dhe fjalët e pandryshueshme.
- Kategoritë gramatikore të emrit, të mbiemrit, të përemrit, të numërorit.
- Forma veprare dhe forma joveprare e foljeve. Kategoritë gramatikore të foljes.
- Parafjalët dhe lokucionet parafjalore.
- Dallimi i parafjalëve nga emrat dhe nga ndajfoljet me të njëjtën formë.
- Dallimi i lidhëzave nga përemrat, ndajfoljet dhe parafjalët me formë të njëjtë.

FJALËFORMIM

- Mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe.

DREJTSHKRIM

- Përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit.
- Përdorimi i drejtë i ligjëratës së drejtë dhe i ligjëratës së zhdrejtë.

- dallon fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore dhe i përdor drejt ato;
- dallon fjalitë njëkryegjymtyrëshe emërore dhe i përdor drejt ato;
- dallon fjalinë e thjeshtë nga fjalia e përbërë;
- përcakton llojet e fjalisë së përbërë dhe i përdor drejt ato;
- dallon fjalitë e përbëra të përziera me më shumë se dy pjesë;
- ndërton skemat e fjalive të përbëra.

MORFOLOGJI

Nxënësi:

- dallon fjalët e ndryshueshme (kategoritë e tyre) dhe fjalët e pandryshueshme);
- përcakton kategoritë gramatikore të emrit, të mbiemrit, të përemrit, të foljes dhe të numërorit;
- përdor saktë në fjali foljet në formën veprare dhe në formën joveprare;
- dallon parafjalët sipas rasave dhe lokucionet parafjalore;
- dallon parafjalët nga emrat dhe ndajfoljet me formë të njëjtë;
- dallon lidhëzat nga përemrat, ndajfoljet dhe parafjalët me formë të njëjtë.

FJALËFORMIM

Nxënësi:

- gjen dhe përdor në fjali fjalët e parme dhe jo të parme si dhe

- Drejtshkrimi i fjalëve që kanë grupet **ye, ua, ue**
- Drejtshkrimi i fjalëve në të cilat takohen dy zanore të njëjta.
- Drejtshkrimi i disa tipave të fjalëve me prejardhje të huaj.
- Drejtshkrimi i njëjës së përparme të emrave, të mbiemrave dhe të përemrave pronorë (*i, e, të, së*).
- Drejtshkrimi i pjesëzave dhe i parafjalëve në rastet e përsëritjes dhe mospërsëritjes së tyre.
- Drejtshkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes.

LEKSIKOLOGJI DHE SEMANTIKË

- Leksiku i gjuhës shqipe dhe pasuria e tij.
- Huazimet në gjuhën shqipe, shmangia e tyre në funksion të ruajtjes dhe pastërtisë së gjuhës shqipe.

mënyrat e formimit të fjalëve jo të parme.

DREJTSHKRIM

Nxënësi:

- përdor drejt shenjat e pikësimit;
- shkruan saktë ligjëratën e drejtë dhe ligjëratën e zhdrejtë;
- shkruan drejt fjalët që kanë grupin *ye, ua, ue*;
- shkruan drejt fjalët në të cilat takohen dy zanore të njëjta;
- përdor drejt apostrofin tek trajtat e shkurtra të përemrit vetor;
- shkruan saktë disa tipa fjalësh me prejardhje të huaj;
- shkruan saktë njëjën e përparme të emrave, të mbiemrave dhe të përemrave pronorë (*i, e, të, së*);
- përdor saktë pjesëzat dhe parafjalët në rastet e përsëritjes dhe mospërsëritjes së tyre;
- shkruan saktë fjalët njësh, ndaras dhe me vizë në mes.

LEKSIKOLOGJI DHE SEMANTIKË

Nxënësi:

- vlerëson pasurinë leksikore të gjuhës shqipe;
- dallon fjalët e huaja nga fjalët në gjuhën shqipe;
- gjen huazime të panevojshme në gazeta dhe në revista dhe i zëvendëson me fjalë të gjuhës shqipe;
- dallon fjalën e huaj që është bërë pjesë e leksikut nga fjalët e huaja


	që kanë fjalën përkatëse në gjuhën tonë.
Vlerat dhe qëndrimet	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerëson pasurinë leksikore të gjuhës shqipe; - respekton diversitetin gjuhësor mes njerëzve; - shfaq shpirt krijues dhe mendim kritik në përdorimin e gjuhës; - shmang fjalët e huaja të panevojshme gjatë komunikimit; - vlerëson punët e të tjerëve; - bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre. 	

XII. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat e të nxënit janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një proces mësimor efektiv. Përdorimi i tyre do të shërbejë për zhvillimin gjuhësor dhe letrar të nxënësve. Mësuesit duhet të përditësojnë çdo ditë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies, me qëllim që të zhvillojnë te nxënësit dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë të suksesshëm dhe aktivë në jetën e përditshme. Metoda, strategji dhe teknika, të tilla si: *diskutim për njohuritë paraprake, kubimi, diagram piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, stuhi mendimi, pyetje autorit, ditarët e të nxënit, pyetja sjell pyetjen* etj. shërbejnë si nxitje për nxënësit në procesin e të nxënit dhe si garanci për rezultate të mira në procesin e të nxënit. Gjithashtu, është e rëndësishme që *nxënësi të punojë me situata të nxëni*, ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve, të tilla si: “*Pse?*”, “*A është gjithmonë e vërtetë?*”, “*Çfarë ndodh kur...?*” etj. Në këtë mënyrë, ai nxitet të reflektojë mbi veprimet e tij dhe të ndërmarrë situata të reja. Përmes situatave të të nxënit, nxënësi eksploron, zbaton dhe integron njohuritë dhe aftësitë gjuhësore, fiton aftësi intelektuale të nevojshme për të zhvilluar të menduarit krijues dhe kritik.

MODEL I NJË SITUATE TË NXËNI

Situata e të nxënit lidhet me shkrimin e një posteri për të ndërgjegjësuar fëmijët që të lexojnë me shumë libra. Nxënësit punojnë në grupe dhe hetojnë formën e shkrimit të një posteri, si dhe



- Procesi i mësimdhënies karakterizohet nga kriteret e mëposhtme:

Kriteret e procesit mësimor

a) Mësimdhënie me në qendër nxënësin

Nxënësit do të jenë në qendër të procesit të mësimdhënies. Ky proces do të ndërtohet në varësi të nevojave, aftësive dhe interesave të nxënësve. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Përpos kësaj, lënda e gjuhës shqipe kërkon që nxënësit të nxënë konceptet, të zhvillojnë shkathtësitë dhe të zbatojnë njohuritë gjuhësore. Këto diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të të nxënësve, të cilat përshtaten me objektin e të nxënësve dhe me nevojat e nxënësve.

b) Të mësuarit bashkëveprues

Mësuesit do të sigurojnë një mjedis të pasur dhe nxitës për komunikim dhe ndërveprim mes nxënësve. Ata do të përdorin metoda, strategji dhe teknika që nxitin të mësuarit bashkëveprues. Gjatë orëve të gjuhës shqipe, nxënësit do të nxitin të punojnë së bashku shpesh. Detyrat e përbashkëta do t'u sigurojnë nxënësve më shumë kohë për të folur dhe për të ndarë përvojat e tyre me njëri-tjetrin. Njëherazi, edhe shkalla e zotërimit të gjuhës rritet. Puna në grupe do të nxisë tolerancën ndaj mendimit të tjetrit dhe do të ndikojë në përdorimin e formave demokratike për të ndarë përgjegjësitë dhe punën.

Puna me nxënësit me nevoja të veçanta, me nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe me nxënësit e talentuar

a) Nxënësit me nevoja të veçanta

Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave dhe me fokus integrimin i krijon mësuesit hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënësve e tyre. Mësuesi duhet të marrë parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxënësve, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grup-moshe. Mësuesi mund të zgjerojë zhvillimin e kompetencave kyç sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe për të zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

b) Nxënësit me vështirësi në gjuhën shqipe

Nxënësit që vijnë kryesisht nga emigracioni, e zotërojnë gjuhën shqipe në nivele të ndryshme. Programi është për të gjithë nxënësit, prandaj

nxënësit me vështirësi në gjuhën shqipe duhet të arrijnë rezultatet e të nxënit si të gjithë nxënësit e tjerë. Këtyre nxënësve duhet t'u jepet mbështetje në formën e kohës shtesë, aq sa u duhet për të mësuar mirë gjuhën shqipe, ose t'u ofrohen kurse formale nga shkolla, përgjatë vitit shkollor ose gjatë pushimeve verore.

Udhëzime për leximin e teksteve letrare dhe joletrare

Gjatë mësimit të gjuhës shqipe nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë, nxënësit do të lexojnë tekste letrare dhe joletrare. Për sa i përket përfaqësimit të teksteve letrare dhe teksteve joletrare, gjatë këtyre dy shkallëve këshillohet të respektohen afërsisht raportet: **70% me 30%**.

Për leximet e teksteve letrare këshillohet të zgjidhen pjesë përfaqësuese nga letërsia shqipe dhe ajo botërore në përshtatje me moshën dhe me zhvillimin e fëmijëve. Këto tekste duhet të plotësojnë kriteret artistike dhe didaktike të gjatësisë, të strukturës dhe të qartësisë së gjuhës. Këshillohet që nxënësit të lexojnë fragmente dhe vepra nga periudha të ndryshme letrare, nga letërsia antike deri tek ajo bashkëkohore, përfshirë këtu edhe krijimtarinë folklorike gojore.

XIII. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në procesin e të nxënit dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien. Vlerësimi i nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe ka për synim matjen e kompetencave të lëndës, të paraqitura nëpërmjet rezultateve të të nxënit.

Llojet e vlerësimit:

Vlerësimi diagnostikues zakonisht kryhet në fillim të shkallës, në fillim të vitit shkollor ose para zhvillimit të një grupi orësh, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat ose aftësitë që kanë nxënësit rreth asaj, për të cilën po kryhet vlerësimi. Ky informacion përdoret për të orientuar praktikatat e mësimdhënies të mësuesit dhe të nxënit e nxënësve, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese. Vlerësimi diagnostikues mund të jetë i shkurtër, i shpejtë, joformal dhe mund të bëhet me gojë dhe me shkrim.

Vlerësimi i vazhdueshëm është një proces që ndodh gjatë gjithë kohës në klasë dhe informon mësuesit dhe nxënësit mbi progresin e këtyre të fundit. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur nga vlerësimi formues përdoren për të përmirësuar proceset e mësimdhënies dhe të nxënësve. Fokusi i vlerësimit formues nuk duhet të jetë vetëm vlerësimi me notë i nxënësve.

Vlerësimi përmbledhës kryhet më shpesh në fund të një grupi orësh për të përcaktuar çfarë është mësuar mbas një periudhe kohe dhe shoqërohet me notë. Vlerësimet përmbledhëse përdoren jo vetëm për të informuar nxënësit e prindërit për progresin e nxënësve, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Gjatë zbatimit të programit, nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë edhe në grup për kryerjen e detyrave që mund të zgjidhen me këtë metodë pune. Në këto raste, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi, dhe të secilit nxënës, në veçanti.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësimi me gojë dhe vlerësimi me shkrim. Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim. Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për prezantimet me gojë, në testimet periodike me shkrim dhe në punët me shkrim, të zhvilluara individualisht ose në grup.

Një formë e vlerësimit me shkrim të nxënësve janë edhe testimet.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm për të matur kompetencat gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, si qortimet nga mësuesi. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, që pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve dhe krijojnë mundësi për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi deri te rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve. Ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Përveç punëve dhe testeve me shkrim, mësuesit mund të kryejnë vlerësime të bazuara në performancën e nxënësve, duke përdorur dhe mënyra, të tilla si: projektet kurrikulare dhe ndërlëndore; loja me role, detyrat individuale, bisedat letrare, debatet, vrojtimit, portofoli i nxënësit etj.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të nxënësit përgjatë një periudhe të caktuar. Ai mund të përmbajë shkrime të ndryshme, detyra tematike, projekte etj. Përzgjedhjet e punëve dhe detyrave për portofolin bëhen nga nxënësi, ndërsa mësuesi rekomandon. Pjesë e vlerësimit është edhe informimi i nxënësve dhe i prindërve për rezultatet e vlerësimit.

XIV. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Për arritjen e kompetencave në fushën “Gjuhët dhe komunikimi” është i rëndësishëm përdorimi i mjeteve dhe i materialeve të shumta mësimore. Tekstet shkollore nuk duhet të jenë burimi i vetëm për marrjen e informacionit. Në procesin e të nxënësve mund të përdoren materiale nga interneti, libra nga biblioteka e shkollës, fletë pune, udhëzues të ndryshëm etj. Këto materiale duhet të jenë të qarta, të sakta, me një gjuhë të kuptueshme, në përputhje me programin dhe të mos krijojnë mbingarkesë për nxënësit.